
Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

UDHËZUESI



PËR

MATJE, KRIJIM, NDRYSHIM DHE REGJISTRIM TË NJËSIVE KADASTRALE

- PARCELË
- NDËRTESË DHE
- PJESË TË NDËRTESËS

Prishtinë, 2024



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA
Nr./Br. 01/1311/24
Nr.i fq./Br.str.
Data/Datum: 12.09.2024
PRISHTINË-PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

Në mbështetje të nën paragrafit 4.2 të nenit 11 dhe paragrafit 5 të nenit 54 të Ligjit Nr. 084/L-237 për Kadastër të pronës së paluajtshme, paragrafit 7 të nenit 9, paragrafit 9 të nenit 16, paragrafit 4 të nenit 18, nenit 22, paragrafit 3 të nenit 26 të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 07/2024 për përcaktimin e përmbatjes së të dhënave dhe mënyrën e krijimit të njësive kadastrale, paragrafit 4 të nenit 4, pargrafit 3 të nenit 7, paragrafit 4 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 12/2024 për matjet kadastrale dhe gjeodezike, tarifën për kryerjen e matjeve, formën dhe madhësinë e shenjave kufitare dhe pikave gjeodezike dhe paragrafi 7 të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 13/2024 për caktimin dhe ri-rregullimin e kufirit të parcelës Agjencia Kadastrale e Kosovës nxjerrë këtë:

Udhëzuesi i punës 01/2024

për matje, krijim, ndryshim dhe regjistrim të njësive kadastrale

(parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës)

Prishtinë, 2024

Fjala e Drejtorit Ekzekutiv



Republika e Kosovës është duke implementuar një infrastrukturë moderne të administrimit të tokës, duke ndjekur kështu praktikën më të mirë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian (BE-së).

Reformat legjislative në fushën e kadastrit po jetësohen çdo ditë e më shumë. Aprovimi i Ligjit për kadastër të pronës së paluajtshme, nga Kuvendi i Kosovës në fund të vitit 2023, është një arritje e rëndësishme në këtë drejtim.

Pas miratimit të Ligjit, me angazhim dhe përkushtim të jashtëzakonshëm, së bashku me stafin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, arritëm që të hartojmë edhe 11 Udhëzime administrative që do të sigurojnë implementimin e suksesshëm të këtij Ligji.

Qëllimi i këtyre reformave ka qenë krijimi i bazës ligjore për avancimin e administrimit të tokës dhe ndjekja e trendeve në shtetet e zhvilluara për të mundësuar qasje më të lehtë nga pikëpamja e koordinimit të aktiviteteve, duke

mundësuar qasje më të lehtë në koordinimin e aktiviteteve, avancimin profesional, përmirësimin e shërbimeve, digjitalizimin e tyre, hapjen e të dhënave, etj.

Ndryshimet në legjislacion kanë ndikuar në mënyrën e kryerjes së punëve kadastrale, gjeodezike dhe pronësoro-juridike. Për të ndihmuar në adaptimin e këtyre ndryshimeve dhe për të lehtësuar implementimin e tyre, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka planifikuar hartimin e disa udhëzuesve të punës, udhëzues që do t'i referohen fillimisht Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Zyrave Kadastrale Komunale, kompanive gjeodete, gjeodetëve të licencuar dhe akterëve të tjerë të interesuar, duke i ndihmuar jashtzakonisht në përmbushjen e detyrave dhe veprimtarive të tyre profesionale.

Ashtu sikurse në të gjitha botimet paraprake që nga koha që unë udhëheq Agjencinë Kadastrale të Kosovës, edhe përpilimi i këtij dokumenti është karakterizuar nga një angazhim gjithëpërfshirës dhe profesional. Në punëtoritë disaditore dhe gjatë shqyrtimit publik të draftit final, kanë kontribuar ekspertë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyrat Kadastrale Komunale, Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës dhe gjeodetë të licencuar, të cilëve u shpreh mirënjohjen time të sinqertë. Edhe pse AKK-ja nuk kishte obligim ligjor për ta vendosur në shqyrtim publik, për të garantuar transparencën dhe gjithëpërfshirjen, u vendos që të ofrohet një periudhë dyjavore për të gjithë që të kontribuojnë.

Unifikimi i procedurave, saktësia dhe definimi i detajeve dhe aktiviteteve që duhen ndjekur dhe kjo për secilin lloj lënde janë disa nga kapitujt e këtij Udhëzuesi të punës. Po ashtu, është përcaktuar në mënyrë të qartë lista e dokumentacionit të nevojshëm për çdo lloj lënde, nga dorëzimi i kërkesës nga pala, standardet e matjeve në terren, deri te krijimi dhe regjistrimi i njësive kadastrale në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.

Duke u bazuar në trendet e fundit dhe zhvillimet në fushën e kadastrit, dinamikën e punës që zhvillohet çdo ditë si dhe projektet dhe avancimet e planifikuara nga AKK-ja për këtë vit, rrjedhimisht edhe Udhëzuesi i punës me kohë mund të ketë nevojë për plotësime e ndryshime. Prandaj, ne jemi të hapur që në çdo kohë të shqyrtojmë të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet të cilat dalin gjatë procesit të punës bazuar në këtë Udhëzues.

Avni N. AHMETI
Drejtor Ekzekutiv i AKK-së

PËRMBAJTJA

Hyrje 08.
1. Kadastri 09
2. Përmbajtja e Kadastrit 10
3. Mirëmbajtja e regjistrit të pronave të paluajtshme 11
4. Llojet e lëndëve 12
5. Kërkesa për regjistrim të ndryshimeve në RDPP 13
6. Protokolli për kërkesat e pranuara nga gjeodeti apo kompania gjeodezike 17
7. Parcela 18
7.1 Matja dhe korrigjimi i të dhënave grafike 19
7.2 Regjistrimi fillestar 23
7.2.1 Numërimi i parcelave me regjistrim fillestar 23
7.3 Krijimi i parcelës nga ndarja 24
7.3.1 Ndarja e parcelave në bazë të gjendjes faktike në terren 24
7.3.2 Parcelimi në bazë të ndarjeve të projektuara 24
7.3.3 Parcelimi në zonat me komasacion 24
7.3.4 Ndarja e bashkëpronësisë 25
7.3.5 Numërimi i parcelave të reja pas ndarjes 26
7.4 Krijimi i parcelës nga bashkimi 27
7.4.1 Bashkimi i parcelave me pronar të njejtë 27
7.4.2 Bashkimi i parcelave me pronarë të ndryshëm 27
7.4.3 Bashkimi i parcelave me kultura të ndryshme 27
7.4.4 Bashkimi i parcelave me të drejta të ndryshme të pronësisë 28
7.4.5 Bashkimi i parcelave në zonat me komasacion 28
7.4.6 Numërimi i parcelave të reja pas procesit të bashkimit 28
7.5 Formati dhe përmbajtja e lëndës për krijimin e parcelës 29
7.6 Raporti teknik për krijimin e parcelës 30
7.7. Manuali për krijimin e parcelës 31
7.8 Manuali për korrigjimin e kufijve të parcelës 32
8. Kthimi i numrit të vjetër të parcelës 33
9. Ndërrimi i kulturës së parcelës 34
10. Caktimi i kufijve të parcelës 35
10.1 Procesverbali i caktimit 36
11. Procesi i ri - rregullimit të kufirit të parcelës 37
11.1 Formati dhe përmbajta e lëndës 39
11.1.1 Raporti teknik 40
11.1.2 Manuali për ri-rregullim 41
12. Identifikimi i njësive kadastrale 42
13. Korrigjimi i sipërfaqeve të parcelave 44
14. Krijimi i ndërtesës si njësi kadastrale 45
14.1 Para regjistrimi i ndërtesës dhe pjesëve të ndërtesave 45
14.2 Matja e ndërtesës 46
14.2.1 Numrimi i ndërtesës 46

14.2.2 Formati dhe përmbajta e lëndës për regjistrim të ndërtesës në regjistrin kadastral 47
14.2.3 Raporti teknik 48
14.2.4 Manuali për ndërtesë 48
14.3 Regjistri i ndërtesës 49
14.4 Ndarja e ndërtesës 50
14.5 Bashkimi i ndërtesave 51
14.6 Ndërrimi i destinimit të ndërtesës 51
14.7 Fshirja e ndërtesës së rrënuar 52
15. Krijimi i pjesës së ndërtesës si njësi kadastrale 53
15.1 Matja e pjesës së ndërtesës 53
15.1.1 Numërimi i pjesës së ndërtesës 53
15.1.2 Formati dhe përmbajta e lëndës 54
15.1.3 Raporti teknik 55
15.1.4 Manuali për pjesë të ndërtesës 55
15.2 Regjistri i pjesës së ndërtesës 56
15.3 Ndarja e pjesës së ndërtesës 57
15.4 Bashkimi i pjesëve të ndërtesave 58
15.5 Ri-rregullimi i kufirit të pjesës së ndërtesës 58
15.6 Ndryshimi i përdorimit të pjesës së ndërtesës 58
16. Krijimi i njësive kadastrale për hapësirat e përbashkëta 59
17. Rastet e veçanta të regjistrimit të ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave 60
17.1 Trajtimi i ndërtimeve pa leje 60
17.1.1 Matja e ndërtesës - Situacioni 60
17.1.2 Dëshmitë nga gjeoportali dhe fotot e ndërtesës 60
17.1.3 Përgatitja e skicave për kate 61
17.1.4 Përgatitja e të dhënave për dorëzim në Kadastër 61
17.1.5 Njësit banesore / Ndërtesat e kategorisë së dytë 62
17.2 Njësitë kadastrale ndërtesë me pjesë të ndërtesave të ndërtuara para vitit 1999 64
17.2.1 Shtëpitë në cilësi të banesës 64
18. Regjistrimet në bazë të aktgjykimeve 65
19. Formati dhe përmbajta e të dhënave të ofruara nga ZKK-të 66
20. Pranimi dhe kontrolli i lëndës nga ZKK dhe AKK 67
21. Korrigjimi i gabimeve për njësi kadastrale 68
22. Matjet kadastrale për të gjitha njësitë kadastrale 69
22.1 Rrjeti referent gjeodezik shtetëror KOSOVAREF01 69
22.2 Kategoritë e burimit të koordinatave 71
22.3 Kodet e pikave 72
22.4 Standardet e matjeve kadastrale 73
22.4.1 Metodat gjeodezike të matjeve kadastrale 73
22.4.2 Saktësia gjatë matjeve me GNSS 74
22.4.3 Kontrolli i saktësisë së matjeve me GNSS 74

22.4.4 Pikat kontrolluese 75
22.5 Forma dhe madhësia e shenjave kufitare dhe pikave gjeodezike 75
23. Certifikimi i instrumenteve gjeodezike 76
24. Shërbimet me matje dhe pa matje në terren 77
25. Korrigjimi i të dhënave për pronarin/shfrytëzuesin në regjistra kadastral 78
26. Regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e servitutit 79
27. Regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e hipotekës 80
28. Regjistrimi i qiradhënies dhe të drejtës së shfrytëzimit 81
29. Regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e barrave dhe ngarkesave tjera 82
30. Ndryshimi i kufijve dhe emrave të zonave kadastrale 82
31. Ndarja dhe bashkimi i zonave kadastrale 83
32. Ndryshimi i kufijve dhe emrave të komunave 83
33. Publikimi i të dhënave 84

Lista e përmbajtjes së tabelave:

Table 1. Toleranca e gabimit për pikat e kufirit për planet kadastrale 19
Table 2. Lista e koordinatave për katet e ndërtesave të banimit 61
Table 3. Stacionet permanente të KOPOS-it 70
Table 4. Shërbimet e sistemit KOPOS 70
Table 5. Kodet e pikave dhe përshkrimi 72
Table 6. Saktësia relative e matjeve dhe devijimi standard 74
Table 7. Devijimi standard në rrafshin horizontal 75

SHKURTESAT

AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
σ	Devijim standard
GNSS	Sistemi global i navigimit satelitor
GPS	Sistemi i pozicionimit global
PM	Pikë e fituar me matje
PT	Pikë e transformuar
PMT	Pikë nga matjet takeometrike
PD	Pikë e digjitalizuar nga hartat kadastrale (1:2500, 1:1000, 1:500) pikë nga vektori zyrtar
PV	Pikë e Verifikuar
KOPOS	Sistemi i pozicionimit në Kosovë
Kosovaref01	Sistemi referent koordinativ i Kosovës
RDPP	Regjistri i të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
ST	Statcion Total
UA	Udhëzim Administrativ
ZK	Zona Kadastrale
ZKK	Zyra Kadastrale Komunale
Gjeodet	Gjeodet i licencuar
Kompani gjeodezike	Kompani gjeodezike e pajisur me leje

Hyrje

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) vepron si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë duke kryer funksion administrativ, dhënie të shërbimeve publike dhe zbatim të politikave. AKK është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësor, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore (IKIH) dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit, respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave.
Si institucion i nivelit qendror, AKK ka kompetenca për nxjerrjen e udhëzuesve dhe kornizave të punës lidhur me të gjitha veprimtaritë kadastrale, dhe është përgjegjëse: për trajnimin dhe certifikimin e personave zyrtar për kryerjen e matjeve kadastrale dhe për aprovimin e regjistrimeve në RDPP në kuadër të ZKK-ve, lëshimin e lejeve për kompani gjeodezike dhe licencës për gjeodet për kryerjen e matjeve kadastrale dhe gjeodezike, mbikëqyrjen e të gjitha aktiviteteve të kryera sipas dispozitave të këtij ligji, zhvillimin dhe zbatimin e rregullt të trajnimeve për stafin e ZKK-ve, kompanive gjeodezike dhe gjeodetët, dhe ndalimin/anulimin e të drejtave që i jep.

AKK është përgjegjëse për vendosjen në çështjet administrative si organ i shkallës dytë në kuadër të kompetencave të saj.

Udhëzuesi i punës duhet të zbatohet në mënyrë të obligueshme për të gjitha procedurat e matjeve, krijimit, ndryshimit, regjistrimit dhe publikimit të njësive kadastrale. Të njëjtat duhen të aplikohen edhe për regjistrim sistematik në projektet për rindërtimin e kadastrit në zonat kadastrale (ZK). Gjatë përgatitjes së këtij Udhëzuesi të punës janë konsultuar shumë burime, duke përfshirë ligjet ekzistuese, udhëzimet administrative, doracakë, udhëzues, korniza dhe standarde ekzistuese si dhe dokumentacione tjera teknike.

1 Kadastri

Kadastri përbëhet nga regjistri i njësive kadastrale, i të drejtave pronësore mbi njësitë themelore të kadastrit, hartave kadastrale dhe i dosjeve të dokumenteve kadastrale në formë analoge dhe digjitale.

Të dhënat mbi pronat e paluajtshme dhe të drejtat e tyre regjistrohen në regjistrin e të drejtave mbi pronat e paluajtshme në Republikën e Kosovës.

Regjistri i të drejtave të pronës së paluajtshme (në tekstin e mëtejmë: Regjistri), është themeluar si mekanizëm që njeh dhe zbaton vlefshmërinë e të drejtave të pronës së paluajtshme në Kosovë sipas ligjeve në fuqi. Administrimi i gjithmbarshëm i këtij regjistri bëhet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: AKK), ndërsa Zyrat Kadastrale Komunale (në tekstin e mëtejmë: ZKK) regjistrojnë të dhënat mbi njësitë kadastrale në Regjistër sipas autorizimit të AKK-së dhe në pajtim me dispozitat e ligjeve dhe udhëzimeve administrative.


> Kadastri është unik dhe i integruar që përmban të dhëna gjeohapësinore, të dhëna mbi njësitë kadastrale dhe të drejtat mbi to në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

2 Përmbajtja e Kadastrit

Kadastri përmban të dhëna për:

1. **Parcela,**
2. **Ndërtesa,**
3. **Pjesë të ndërtesave,**
4. **Përçoja,**
5. **Të drejtat mbi pronat e paluajtshme,**
6. **Kufijtë e njësive administrative dhe**
7. **Dokumentacionet tjera grafike dhe alfanumerike për njësitë kadastrale dhe të drejtat mbi to.**

Të dhënat përmbajtësore të secilës nga këto janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.




3 Mirëmbajtja e regjistrit të pronave të paluajtshme

Ushtrimi i detyrave administrative në fushën e kadastrit dhe regjistrimit të paluajtshmërive në nivel komunal bëhet nga Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK), të cilat me Ligjin në fuqi veprojnë në kuadër të AKK-së, si pjesë përbërëse e saj, ashtu që edhe në rrafshin profesional monitorohen nga AKK-ja dhe realizojnë përgjegjësi të deleguara sipas Ligjit për Kadastër.

ZKK-ja është përgjegjëse për: mirëmbajtje të shënimeve kadastrale, regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme, kontrollimin e të dhënave të përgatitura nga kompania gjeodezike apo gjeodeti, vendosjen në çështje administrative si organ i shkallës së parë dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe detyra të dhëna nga AKK.

Procedura për mirëmbajtjen e rregullt iniciohet me kërkesë të palës ose sipas detyrës zyrtare.



4 Llojet e lëndëve

Mirëmbajtja e të dhënave në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme realizohet përmes këtyre proceseve për të cilat duhet të nxirren aktvendime:

1. **Krijimi i parcelës përmes regjistrimit fillestar,**
2. **Ndarja e parcelës,**
3. **Bashkimi i parcelave,**
4. **Ri-rregullimi i kufirit të parcelës,**
5. **Ndërrimi i kulturës së parcelës,**
6. **Para regjistrimi i ndërtesës,**
7. **Para regjistrimi i pjesës së ndërtesës,**
8. **Regjistrimi i ndërtesës,**
9. **Ndarja e ndërtesës,**
10. **Bashkimi i ndërtesave,**
11. **Ndërrimi i destinimit të ndërtesës,**
12. **Fshirja e ndërtesës,**
13. **Regjistrimi i pjesës së ndërtesës,**
14. **Ndarja e pjesës së ndërtesës,**
15. **Bashkimi i pjesëve të ndërtesës,**
16. **Ri-rregullimi i kufirit të pjesës së ndërtesës,**
17. **Ndërrimi i destinimit të pjesës së ndërtesës,**
18. **Fshirja e pjesës së ndërtesës,**
19. **Caktimi i kufijve të parcelave,**
20. **Identifikimi i njësive kadastrale,**
21. **Regjistrimi i përçojave,**
22. **Ndryshimi/modifikimi i përçojave,**
23. **Fshirja e përçojave,**
24. **Korrigjimi i gabimeve për njësi kadastrale,**
25. **Krijimi dhe regjistrimi i njësisë në bazë të aktgjykimit,**
26. **Ndryshimi i llojit të të drejtave dhe formave të pronësisë së pronave të paluajtshme,**
27. **Ndarja e bashkëpronësisë,**
28. **Regjistrimi i të drejtës së pronësisë,**
29. **Ri-regjistrimi i të drejtave sendore në paluajtshmëri,**
30. **Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit,**
31. **Regjistrimi i vërejtjes në RDPP,**
32. **Regjistrimi i barrave dhe ndalesave,**
33. **Regjistrimi i të drejtës së qirasë,**
34. **Regjistrimi i servitutit,**
35. **Modifikimi i servitutit,**
36. **Fshirja e servitutit,**
37. **Regjistrimi e hipotekës,**
38. **Modifikimi e hipotekës,**
39. **Fshirja e hipotekës,**
40. **Korrigjimi/plotësimi i të dhënave për pronar/shfrytëzues dhe**
41. **Korrigjimi i të drejtave mbi pronat e paluajtshme.**

5 Kërkesa për regjistrim të ndryshimeve në RDPP

Ndryshimet në RDPP bëhet nga Zyrat Kadastrale Komunale të cilat janë funksionale në të gjitha komunat. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në RDPP bëhet në ZKK-në ku ndodhet njësia kadastrale me shkrim apo në formë elektronike nga:

- **Pronari i njësisë kadastrale,**
- **Shfrytëzuesi i regjistruar në RDPP,**
- **Personi i cili fiton të drejtën e pronësisë, shfrytëzimit me akt juridik të plotfuqishëm,**
- **Cilido person që ka interes juridik apo me autorizim, ose**
- **Njëri nga trashëgimtarët me dëshmi vdekje.**

ZKK-ja regjistron kërkesën dhe për të njëjtën lëshon dëshminë e cila përmban numrin e protokollit, kohën dhe datën e pranimit të saj.
Ndryshimet në RDPP bëhen duke u bazuar në ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi dhe udhëzuesve për procesin e punës.

Llojet e lëndëve për të cilat parashtrohet kërkesa në ZKK:

1. Regjistrimi i të drejtës së pronësisë,
2. Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit,
3. Regjistrimi i të drejtës së qirasë,
4. Regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e hipotekës,
5. Korrigjimi/plotësimi i të dhënave për pronar/shfrytëzues,
6. Korrigjimi/plotësimi i të drejtave mbi pronat e paluajtshme,
7. Regjistrimi i vërejtjes në RDPP,
8. Regjistrimi i barrave dhe ndalesave,
9. Ri-regjistrimi i të drejtave sendore në paluajtshmëri,
10. Krijimi dhe regjistrimi i njësisë në bazë të aktgjykimit dhe akteve tjera jurdike,
11. Ndërrimi i kulturës së parcelës pa matje dhe
12. Ndërrimi i destinimit të ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës pa matje.

Llojet e lëndëve për të cilat parashtrohet kërkesa te gjeodeti, kompania gjeodezike, apo personi zyrtar i certifikuar në institucionin publik përveç AKK-së dhe ZKK-së janë:

1. Krijimi i parcelës përmes regjistrimit fillestar,
2. Ndarja e parcelës,
3. Bashkimi i parcelave,
4. Ri-rregullimi i kufirit të parcelës,
5. Ndërrimi i kulturës së parcelës me matje,
6. Krijimi i ndërtesës,
7. Para regjistrimi i ndërtesës,
8. Para regjistrimi i pjesës së ndërtesës,
9. Ndarja e ndërtesës,
10. Bashkimin i ndërtesave,
11. Ri-rregullimi i kufirit të pjesës së ndërtesës,
12. Fshirja e ndërtesës,
13. Krijimi i pjesës së ndërtesës,
14. Ndarja e pjesës së ndërtesës,
15. Bashkimi i pjesëve të ndërtesës,
16. Fshirja e pjesës së ndërtesës,
17. Ndërrimi i destinimit të ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës me matje,
18. Regjistrimi/modifikimi/fshirja e servitutit,
19. Caktimi i kufijve të parcelave,
20. Identifikimi i njësive kadastrale,
21. Korrigjimi i gabimeve për njësi kadastrale,
22. Legalizimi i objekteve të ndërtuara pa leje,
23. Regjistrimi i përçojave,
24. Ndryshimi/modifikimi i përçojave,
25. Fshirja e përçojave.

Kërkesa për zbatimin e ndryshimit duhet të paraqitet brenda periudhës së përcaktuar me ligj, në formularët e përcaktuar (Shtojca 1), që përmbajnë:

1. Emri i gjeodetit apo kompanisë gjeodezike,

2. Numri i licencës,

3. Komuna,

4. Zona kadastrale,

5. Numri i lëndës së protokollit të gjeodetit,

6. Lloji i njësisë,

7. Numri i njësisë kadastrale,

8. Të dhënat për parashtruesin e kërkesës:
    a. Emri / emri i kompanisë,
    b. Mbiemri,
    c. Emri i njërit prind,
    d. Numri personal / numri i biznesit,
    e. Adresa,
    f. E-mail dhe
    g. Numri i telefonit.

9. Të drejtat e parashtruesit të kërkesës mbi njësinë kadastrale:
    a. Pronari i njësisë kadastrale,
    b. Shfrytëzuesi i regjistruar në RDPP,
    c. Personi i cili fiton të drejtën e pronësisë, shfrytëzimit me akt juridik të plotfuqishëm,
    d. Cilido person që ka interes juridik apo me autorizim ose
    e. Njëri nga trashëgimtarët me dëshmi vdekje.

10. Lloji i shërbimit kadastral të ofruar nga gjeodetët/kompanitë gjeodezike,

11. Kërkesa mund të bëhet me shkrim apo në formë elekontronike dhe

12. Lista e dokumenteve të nevojshme për secilin shërbim.

Kërkesa duhet të jetë e nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës, data e parashtrimit dhe e vulosur nga subjekti i licencuar.

Lista e dokumenteve të nevojshme:

1. Letërnjoftimi apo pasaporta/certifikata e biznesit e parashtruesit të kërkesës (kopje),
2. Autorizimi i vërtetuar te organi kompetent,
3. Dëshmia e vdekjes së pronarit/shfrytëzuesit apo vendimi i trashëgimisë, nëse kërkesa parashtrohet nga trashëgimtarët,
4. Pëlqimet nga organet tjera,
5. Dokument tjetër juridik /Vendime/Aktgjykime,
6. Certifikata e Përdorimit të ndërtesës.

Kur është e nevojshme të kryhen punime/matje gjeodezike në terren për zbatimin e ndryshimit dhe kur punimet kryhen nga gjeodeti/kompania gjeodezike, si dhe kërkesa e drejtuar në këtë rast përmban gjithashtu autorizimin, atëherë gjeodeti apo kompania gjeodezike në emër të saj mund ta bëjë kërkesën për të dhëna nga ZKK duke bashkangjitur kërkesën për shërbime nga pala dhe nuk ka nevojë për autorizim si titull i veçantë.

Gjeodeti apo kompania gjeodezike është e detyruar të paraqes kërkesën jo më vonë se tri ditë pune nga data e dhënies së kërkesës nga pala përmes kërkesës së parashtruar tek ai/ajo. Në rastin e paraqitjes së kërkesës pala/parashtruesi i kërkesës duhet të ketë dokumentin identifikues me afat. Gjeodeti apo kompania gjeodezike kërkesën mund ta parashtroj fizikisht apo në formë elekontronike për të cilën mjafton vetëm kërkesa e palës te gjeodeti dhe pagesa për produktin. Kur për ndryshimin i kërkohet një analizë më e gjërë gjeodetit, me të njëjtën pagesë i ofrohen edhe shërbimet tjera.

6 Protokolli për kërkesat e pranuara nga gjeodeti apo kompania gjeodezike

Gjeodeti apo kompania gjeodezike duhet të mbajë protokollin për kërkesat e pranuara nga palët, në formë digjitale.

Regjistri i protokollit mbahet në kuadër të një viti kalendarik dhe duhet të ketë këtë përmbajtje (*shtojca 2*):

1. Numri rendor i protokollit,
2. Emri (emri i prindit) mbiemri / emri i kompanisë së parashtruesit të kërkesës,
3. Adresa,
4. Numri personal / numri i biznesit i parashtruesit të kërkesës,
5. Numri i telefonit,
6. Lloji i shërbimit të ofruar,
7. Komuna në të cilën gjendet prona,
8. Zona Kadastrale në të cilën gjendet prona,
9. Lloji dhe numri i njësisë kadastrale,
10. Data e paraqitjes së kërkesës së palës,
11. Data e paraqitjes së kërkesës për produkte në ZKK,
12. Data e ekzekutimit të punimeve në terren,
13. Data e dorëzimit të lëndës në ZKK,
14. Numri i protokollit nga ZKK,
15. Vlera e pagesës së palës për gjeodetin/kompaninë gjeodezike për shërbimin e ofruar,
16. Data e përfundimit të lëndës nga ZKK,
17. Evidentimi i mangësive të shënuara në procesverbal gjatë shqyrtimit dhe pranimit të lëndës në ZKK dhe
18. Vërejtje / Sqarim.

7 Parcela

Në kuadër të mirëmbajtjes së regjistrit mbi të dhënat kadastrale krijohen njësi të reja kadastrale përmes llojeve të ndryshme të lëndëve. Secila nga këto lëndë përmban rregulla dhe dokumentacion përkatës në bazë të të cilës realizohen azhurnimet në regjistrin e të dhënave kadastrale.

Parcela është sipërfaqe e përkufizuar e tokës e identifikuar me numër të parcelës dhe e paraqitur në hartën kadastrale me sipërfaqe të regjistruar në RDPP dhe të paraqitur në projeksion hartografik.

Parcela përmban:

1. Numrin unik dhe emrin e zonës kadastrale;
2. Numrin e parcelës,
3. Kufirin e parcelës,
4. Komunën,
5. Tipin e pronës,
6. Lojin e pronës,
7. Kulturën, klasën/shfrytëzimi,
8. Sipërfaqen,
9. Të drejtat mbi parcela,
10. Të dhënat për pronarin apo shfrytëzuesin e regjistruar dhe
11. 11. Vendi i quajtur.

Krijimi i parcelave të reja kryhet përmes regjistrimit fillestar, ndarjes ose bashkimit.

Ndarja apo bashkimi i parcelave mund të regjistrohen:

1. 1Nëse parcelat janë të lira nga hipotekat dhe ngarkesat tjera,
2. Nëse kreditori apo poseduesi i të drejtave pronësore jep pëlqim për ndarje apo bashkim të parcelës,
3. Nëse kreditori apo poseduesi i të drejtave pronësore ka dhënë pëlqimin e tij për një rend të ri të prioriteteve në parcelën e re,
4. Nëse ekzistojnë hipoteka apo barra tjera të regjistruara me kreditor të ndryshëm në parcelat të cilat bashkohen, atëherë e drejta e hipotekës apo barrave tjera realizohet në njësinë kadastrale të re nga kreditorët në përpjesëtim me hipotekimin apo barrën fillestare të regjistruar.

Në zonat urbane krijimi i parcelës bëhet pavarësisht planit urbanistik për qëllime të ndarjes së pronësisë apo krijimit të bashkëpronësisë. Kur ndarja ose bashkimi i parcelave në zonat urbane bëhet për qëllim të ndërtimit, para se të merret leja e

ndërtimit pronari, investitori ose personi tjetër i autorizuar është i obliguar që paraprakisht të krijoj gjendjen juridike dhe kadastrale sipas planit urbanistik.
Duhet të krijohet paraprakisht parcela ndërtimore, në të kundërtën nuk mund të regjistrohet ndërtesa me leje ndërtimore dhe certifikatë të përdorimit.

Ndarja, bashkimi dhe ri-rregullimi i kufirit të parcelave mund të bëhet kur ekzistojnë objektet e kategorisë së parë (I) të legalizuara dhe të regjistruara në regjistra kadastral, por ndarja, bashkimi dhe ri-rregullimi nuk mund të bëhen, kur objektet e kategorisë së parë janë me leje ndërtimore pavarësisht a janë të regjistruara.
Ndarja, bashkimi dhe ri-rregullimi i kufirit të parcelave gjithashu nuk mund të bëhet kur ekzistojnë objektet e kategorisë së dytë (II) pavarësisht a janë të regjistruara në regjistrat kadastral, dhe në këto raste kërkohet pëlqimi nga organi kompetent për çdo ndryshim.

7.1 Matja dhe korrigjimi i të dhënave grafike

Matja dhe korrigjimi i të dhënave në pjesën grafike, gjegjësisht i të dhënave vektoriale duhet të bëhet pas çdo matjeje të krijimit apo identifikimit/shënimit të njësisë kadastrale (parcelës) në mënyrë që parcela ta merrë statusin “e matur”, poashtu pikat e parcelës.
Për të gjithë pikat e kufijve të parcelave të cilat kanë statusin e pikave të pa matura duhet të bëhen matje në terren, kurse për pikat të cilat nuk kanë mundur të maten duhet të jepen arsyet dhe dëshmitë për mos matje. Pas matjes së parcelës bazë dhe përpunimit të të dhënave, të njëjtat krahasohen me pjesën grafike dhe pjesën tekstuale. Nëse gjeodeti konstaton që ka ndryshime në mes të të dhënave në terren për parcelën bazë me të dhënat nga pjesa grafike apo edhe atë tekstuale, atëherë kryhen dhe kërkohen analizat si më poshtë:

1. Kur parcela është e krijuar nga plani kadastral dhe ndryshimet mes gjendjes faktike dhe vektorit janë brenda tolerancës së përcaktuar në tabelën 1, atëherë së pari duhet të bëhet korrigjimi i vektorit nga pjesa grafike dhe pastaj të vazhdohet me kërkesën e palës. Ky lloj korrigjimi i vektorit bëhet vetëm për kufijtë e parcelave të cilat burimin e kanë në hartat kadastrale (1:500, 1:1000, 1:2500);

Shkalla e planit kadastral	0.4mm x P (shkalla e planit)	Toleranca
1:500	0.4mm x 500	< 0.20m
1:1000	0.4mm x 1000	< 0.40m
1:2500	0.4mm x 2500	< 1.00m

Table 1. Toleranca e gabimit për pikat e kufirit për planet kadastrale

2. Kur për parcelën, edhe pse ekziston në pjesën grafike por nuk është e matur, gjenden të dhëna nga fletorja takeomterike.
Matja nga gjeodeti duhet të bëhet fillimisht në atë pjesë ku është duke e zhvilluar aktivitetin duhet të gjejë minimum një pikë të vjetër poligonale, e cila është shfrytëzuar/përdorur në procesin e matjes për parcelën apo bllokun e parcelave që trajtohen dhe i kanë koordinatat e njohura. Pastaj duhet të bëhet matja e kësaj pike me instrument duke shfrytëzuar rrjetin gjeodezik dhe të bëhet krahasimi i koordinatave të matura me ato të fituara nga transformimi. Ndryshimi i cili fitohet duhet të korrigjohet në koordinatat e pikave të njësisë kadastrale. Pas kësaj subjekti i licencuar për shërbime gjeodezike përpilon një raport detal, ku i paraqet të gjitha të gjeturat dhe hapat të cilët i ka ndërmarrë për korrigjimin e atyre të gjeturave. Nëse nuk ka gjendje faktike, atëherë të dhënat nga fletorja takeometrike shënohen/caktohen në terren dhe regjistrohet në regjistra kadastral si kufi final dhe të gjitha pikat regjistrohen si të matura. Në rast se ka mospërputhje të madhe, atëherë ZKK/AKK duhet t'i sigurojë të dhënat për gjeodetin për atë pjesë. Gjeodeti duhet të bëj analizën e gjithë parcelave përreth, të përshkruaj në raport teknik procesin e kontrollit, krahasimit dhe në fund të nxjerrë konstatimin për korrigjimin apo jo të kufijve dhe sipërfaqes sipas fletorës takeomterike. Nëse gjeodeti apo kompania gjeodete nuk arrinë të realizoj një gjë të tillë, ai është i obliguar të përpiloj një raport në të cilin e pasqyron rrjedhën e punës dhe të njëjtin e dorëzon në AKK;

3. Kur për parcelën ekzistojnë të dhëna nga manualet e vjetra, të para vitit 1999 apo pas vitit 1999, të cilat mund të jenë të regjistruara gabim, të njëjtat koordinata duhet të transformohen nga sistemi Gauss Kryger në Kosovaref01. Matja nga gjeodeti duhet të bëhet ashtu që fillimisht duhet të gjejë në atë pjesë ku është duke e zhvilluar aktivitetin minimum një pikë të vjetër poligonale, e cila është shfrytëzuar/përdorur në procesin e matjes për parcelën apo bllokun e parcelave që trajtohen dhe i kanë koordinatat e njohura. Pastaj duhet të bëhet matja e kësaj pike me instrument duke shfrytëzuar rrjetin gjeodezik, dhe të bëhet krahasimi i koordinatave të matura me ato të fituara nga transformimi. Ndryshimi i cili fitohet duhet të korrigjohet në koordinatat e pikave të njësisë kadastrale. Pas kësaj subjekti i licencuar për shërbime gjeodezike përpilon një raport detal, ku i paraqet të gjitha të gjeturat dhe hapat të cilët i ka ndërmarrë për korrigjimin e atyre të gjeturave. Nëse nuk ka gjendje faktike, atëherë të dhënat nga manuali shënohen/caktohen në terren dhe regjistrohen në regjistra kadastral si kufi final dhe të gjitha pikat regjistrohen si të matura. Në rast se ka mos përputhje të mëdha, atëherë ZKK/AKK duhet t'i sigurojë të dhënat për gjeodetin për atë pjesë. Gjeodeti duhet të bëj analizën e gjithë parcelave përreth, të përshkruaj në raport teknik procesin e kontrollit, krahasimit dhe në fund të nxjerrë konstatimin për korrigjimin apo jo të kufijve dhe sipërfaqes sipas manualit.

Nëse gjeodeti apo kompania gjeodezike nuk arrinë të realizoj një gjë të tillë, ai është i obliguar të përpiloj një raport në të cilin e pasqyron rrjedhën e punës dhe të njëjtin e dorëzon në AKK;

4. Kur për parcelën e cila është e regjistruar në pjesën grafike, por pas matjes dhe përpunimit të të dhënave, konstatohet që ka gabim në lexim gjatë matjes apo zhvendosje në pikën e stacionit apo në orientim të pikës së njohur të matur, gjatë krijimit të asaj parcele, atëherë fillimisht bëhet kontrollimi i gjendjes faktike me pjesën grafike dhe me pjesën tekstuale, gjetja e dokumentit të krijimit të parcelës, hulumtimi i imazheve apo ortofotove në periudhën e krijimit të parcelës dhe analiza e parcelave fqinje. Në bazë të analizës duhet të bëhet konstatimi i këtyre gabimeve nga gjeodeti apo kompania gjeodezike dhe duhet të përgatitë lëndën për ndryshime/korgjime që duhet të bëhen në atë parcelë/parcela;

5. Kur nga pika 4, kemi të bëjmë me zhvendosje të bllokut të parcelave, atëherë studimi/korrigjimi të bëhet nga ZKK/AKK;

6. Kur për parcelën, e cila është e regjistruar në pjesën grafike gjendet një hartë kadastrale apo harta të tjera me shënime kadastrale, për të cilën ka ndryshime apo plotësime, atëherë duhet të bëhet digjitalizimi i hartës/skicës, matja në terren dhe krahasimi i tyre. Toleranca për regjistrimin/korrigjimin e gabimit vlenë nga tabela 1;

7. Kur për parcelën, e cila është e regjistruar në pjesën grafike gjendet një fotoskicë/ skicë e kashëruara/skicë, për të cilën ka ndryshime apo plotësime të asaj parcele, atëherë duhet të bëhet digjitalizimi i hartës/skicës, matja në terren dhe krahasimi i tyre. Toleranca për regjistrimin/korrigjimin e gabimit vlenë nga tabela 1

8. Për parcelat e krijuara me aerofotografim fillimisht matet gjendja faktike krahasohet me fotoskica nëse ZKK i posedon, skica plotësuese nëse ZKK i posedon dhe plane, dhe bëhet kontstatimi mbi korrigjimin e të dhënave grafike sipas gjendjes faktike.

Për rastet ku kërkohet gjetja e pikës poligonale nëse gjeodeti/kompania gjeodezike nuk e gjen atë pikë e cila është shfrytëzuar për matje atëherë, nëse ndryshimet nga fletorja takeometrike/manualet, gjendja faktike është brenda tolerances prej 0.30 m në mes të koordinatave të transformimit dhe atyre të kufirit të gjendjes faktike, atëherë gjendja faktike regjistrohet në regjistra kadasral si kufi final dhe të gjitha pikat regjistrohen si të matura.

Për mos përputhjet më të mëdha duhet fillimisht të kryhen matje të të gjitha pikave që janë të mundshme për analizë edhe të kufijve të parcelave përreth. Pastaj kryhet analiza e sipërfaqeve për pjesën grafike dhe tekstuale për të gjitha parcelat përreth dhe në rast të mungesës së shënimeve në pjesën grafike apo tekstuale analizohen planet dhe librat kadastral. Nëse parcelat përreth kanë gabime minimale apo me korrigjim minimalizohen ato, atëherë korrigjimi lejohet. Në raport teknik duhet të ceken të gjitha ndryshimet dhe rrjedhoja e tyre për vendosje të lëndës për aprovim të korrigjimit.

Për një parcelë vetëm një herë ka të drejtë të korrigjohen të dhënat, pasi e njëjta e merr statusin e verifikuar.

Gjeodeti/kompania gjeodezike për të gjitha matjet/korrigjimet e gjetura/konstatuara duhet të përgatitë lëndën/raportin gjeodezik, ku përshkruhet konstatimi i veçantë, e cila do të përcaktohet në (shtojcën 34). Nëse për të njëjtën njësi ka edhe ndryshime tjera lënda dorëzohet si një lëndë e vetme.
Nëse parashtruesi i kërkesës nuk ka procedurë tjetër atëherë lënda për korrigjim duhet të përmbajë:

1. Kërkesa e palës tek gjeodeti/ kompania gjeodezike,
2. Letërnjoftimi/pasaporta kopje i parashtruesit të kërkesës,
3. Procesverbali,
4. Lista e koordinatave të gjendjes së korrigjuar dhe atyre për gjendjen e marrë nga ZKK,
5. Dëshmia e listës se koordinatave për parcelën bazë të lëshuar nga ZKK apo dëshminë mbi pagesën e të dhënave në formatin digjital,
6. Konstatimi mbi korrigjimin dhe
7. Manuali i korrigjimit (shtojca 36).

ZKK/AKK është e obliguar pas dorëzimit të lëndës së kompletuar nga gjeodeti të bëjë ndryshimet/korrigjimet në regjistrat kadastral. Për të njëjtat duhet të nxirret aktvendim nga ZKK/AKK për aprovimin e ndryshimit.

7.2 Regjistrimi fillestar

Regjistrimi fillestar i parcelës nënkupton kur për atë njësi mungojnë shënimet grafike/numerike dhe/apo pjesa tekstuale në regjistrat kadastral, përkatësisht nuk ka qenë e regjistruar asnjëherë në Regjistër, por për të njëjten pala paraqet gjendjen faktike për të cilën krijohet akti juridik përmes Rindertimit. Regjistrimi fillestar është për një apo disa parcela ku mungojnë të dhënat kadastrale për të cilat duhet të udhëheqet procedura e Rindërtimit.

Regjistrimi fillestar mund të bëhet edhe në rastet pas përfundimit të projektit të rindërtimit.

Rastet e këtilla, duhet të trajtohen fillimisht nga aspekti juridik, përkatësisht për njësinë kadastrale, pas përfundimit të projektit të Rindërtimit mund të ndiqet procedurë gjyqësore apo tjetër e paraparë me legjislacionin në fuqi, e pas përfundimit të të cilës krijohet një titull juridik i pronësisë me një dokument të plotfuqishëm, ku i njejti do të zbatohet për herë të parë në kadastër.Agjencia Kadastrale e Kosovës do të kujdeset që gjatë rindërtimit të kadastrit në zonat të cilat u mungojnë shënimet grafike/numerike dhe/apo pjesa tekstuale, që parimisht të rindertojnë pjesen grafike/numerike të njësive kadastrale sipas gjendjes faktike për të gjithë zonen.

7.2.1 Numërimi i parcelave me regjistrim fillestar

Çdo parcelë e re e krijuar me regjistrim fillestar merr numër të ri kadastral unik brenda Zonës Kadastrale. Nëse për të njëjten zonë vetëm ekzistojnë parcela tjera atëherë kemi dy mundësi:

1. Parcela e re e krijuar merr numrin të cilën pala e ka prezantuar nga dokumentet e gjetura, apo numrin e fundit brenda zonës kadastrale +1, nëse në atë zonë kadastrale numri i fundit është 2247, atëhere parcela e re e krijuar do të ketë numër 2248,

2. Kurse, nëse për atë zonë mungojnë të gjitha shënimet e parcelave atëherë bazë e krijimit mund të jenë shënimet manuale (harta, plane), gjenden dhe ruhen numërat, apo fillon numërimi i ri.

7.3 Krijimi i parcelës nga ndarja

Ndarja e parcelave kadastrale përbëhet nga të dhënat më të reja mbi parcelat dhe nga një tërësi formularësh, të përcaktuara me shtojcat e mëposhtme.
Procesi i ndarjes së një parcele është specifikuar në rastet në vijim:

7.3.1 Ndarja e parcelave në bazë të gjendjes faktike në terren

Në rastet kur ndarja e parcelës bëhet sipas gjendjes faktike e cila shfrytëzohet në terren që nënkupton një sipërfaqe të kufizuar me shenja ekzistuese si muri, rrethojë, kunj metalik, kunj druri apo shenjë tjetër, atëherë gjeodeti duhet së pari të bëjë rilevimin e gjendjes faktike. Pasi që të bëhet rilevimi duhet të përpunohen të dhënat dhe të njëjtat të krahasohen me kufirin e parcelës bazë, sipas nënkapitullit 7.1, pastaj të vazhdohet me ndarjen e parcelave sipas gjendjes faktike.

7.3.2 Parcelimi në bazë të ndarjeve të projektuara

Në rastet kur parcela bazë, e cila do t'i nënshtrohet ndarjes, ka koordinata të matura atëherë së pari bëhet projektimi i parcelave në zyrë, pastaj bëhet caktimi dhe matja e pikave ndarëse në terren, si dhe përgatitet lënda për dorëzim në ZKK.

Në rastet kur ndryshimi i kufirit konstatohet në mes të parcelës bazë me gjendjen faktike, atëhere trajtohet sipas nënkapitullit 7.1, bëhet konstatimi për korrigjim, pastaj vazhdohet me projektimin e parcelave dhe caktimin i tyre në terren, dhe të njëjtat pika maten dhe pëgatitet lënda për dorëzim në ZKK.

7.3.3 Parcelimi në zonat me komasacion

Në masën e rregullimit të tokës në të cilën është bërë rregullimi i tokës nuk mund të bëhet ndryshimi i formës, i drejtimit dhe zvogëlimit të sipërfaqes së parcelave kadastrale në zonat kadastrale, përveç në rastin e pëlqimit me shkrim nga Komisioni për Rregullimin e Tokës.

Pëlqimi nga Komisioni për Rregullimin e Tokës nuk duhet në rastet e krijimit të parcelave të reja kadastrale, të cilat pas ndarjes nuk janë më të vogla se 1 ha.
Parcelat e reja që krijohen në zonat me komasacion duhet të ruajnë funksionin e parcelës e cila është subjekt i ndryshimit, pra parcelat e reja që krijohen duhet të kenë çasje në rrugët ekzistuese dhe forma e parcelave të reja duhet të jetë konform parcelës bazë.

7.3.4 Ndarja e bashkëpronësisë

Ndarja e bashkëpronësisë është e definuar me udhëzimin administrativ nr. 07/2024 për përcaktimin e përmbajtjes së të dhënave dhe mënyrën e krijimit të njësive kadastrale.

Për ndarjen e bashkëpronësisë në zonat urbane, për të cilat ekziston akti juridik me sipërfaqen e përcaktuar në të, në të cilat raste më parë nuk është dhënë pëlqim për ndarje, gjegjësisht deri në vitin 2019 duhet të veprohet si në vijim:

Gjeodeti/kompania gjeodezike bazuar në kërkesën e palës dhe dokumentacionin e ofruar bënë matjen e gjendjes faktike në terren. Nëse sipërfaqja që derivon nga matjet e gjendjes faktike në terren përputhet me sipërfaqen e cekur në aktin juridik, në bazë të të cilit është bërë bashkëpronar në certifikatën e pronës, atëherë gjeodeti përpilon procesverbalin në të cilin duhet të nënshkruajnë fqinjët me të cilët kufizohet pjesa e parcelës e cila është në trajtim. Fqinjët të cilët nënshkruajnë në procesverbal duhet të jenë bashkëpronarë në parcelën bazike dhe të njejtit të figurojnë edhe në certifikatën e pronës. Nënshkrimin mund ta bëjë edhe personi i autorizuar nga bashkëpronari ose trashëgimtari i bashkëpronarit i cili e dëshmon këtë me dëshminë e vdekjes së bashkëpronarit.
Në rastet kur sipërfaqja nga gjendja faktike nuk përputhet me atë të aktit juridik, atëherë në këto raste gjeodeti/kompania gjeodezike duhet të konstatoj me një raport të veçantë ndryshimet ndërmjet sipërfaqeve të gjendjes faktike dhe juridike. E njëjta nga gjendja faktike me raportin e gjeodetit zbatohet (regjistrohet parcelimi) dhe zbatohet ndarja e bashkëpronësisë në bazë të sipërfaqes së gjendjes faktike.

Pas përfundimit të procesit të matjes dhe përpilimit të procesverbalit gjeodeti kompleton lëndën me dokumentacionin si në vijim:

1. Kërkesa e palës tek gjeodeti/ kompania gjeodezike,
2. Letërnjoftimi/pasaporta kopje i parashtruesit të kërkesës,
3. Letërnjoftimi/pasaporta kopje i fqinjëve të nënshkruar në procesverbal,
4. Procesverbali,
5. Manualin ku duhet të paraqiten emrat e fqinjëve të parcelës të cilët kanë nënshkruar në procesverbal,
6. Regjistri i ndërrimeve,
7. Lista e koordinatave të njësisë së re dhe atyre për parcelën bazë dhe
8. Dëshmia e listës se koordinatave për parcelën bazë të lëshuar nga ZKK dhe dëshminë mbi pagesën e të dhënave në formatin digjital.


Në rastet kur kontrata për krijimin e bashkëpronësisë ka të bashkangjitur manualin e përpiluar nga gjeodeti në kohën kur është krijuar bashkëpronësia, atëherë në këto raste nuk duhen nënshkrimet nga fqinjët. Manuali duhet të ketë informacionet e sakta për pozicionin e pjesës së pronësisë, duhet t'i ketë koordinatat e pikave në Kosovaref01. I njëjti manual së bashku me kontratën duhet të dorëzohet në ZKK për zbatim duke e plotësuar lëndën me shënimet e kërkuara sipas UA në fuqi dhe udhëzuesit.

Në rastet kur palët nuk pajtohen me sipërfaqen që është derivat nga matjet e gjendjes faktike në terren, atëherë duhet të trajtohet e gjithë parcela bazë.

Në rastet kur njëri nga bashkëpronarët e ka pjesën e tij në hipotekë, atëherë duhet të njoftohet banka.

7.3.5 Numërimi i parcelave të reja pas ndarjes

Në rastet kur parcela me numër p.sh. P-71914059-00125-0 ndahet në dy pjesë, atëherë parcelat e reja në këtë rast marrin numrin P-71914059-00125-1 dhe P-71914059-00125-2 derisa numri i parcelës bazë P-71914059-00125-0 kalon në arkiv.
Në rastet kur parcela me numrin p.sh. P-71914059-00125-1 ndahet në tri pjesë, atëherë parcelat e reja në këtë rast marrin numrin P-71914059-00125-3, P-71914059-00125-4, P-71914059-00125-5, derisa parcela P-71914059-00125-1 kalon në arkiv.
Numërimi për ndarjet duhet të filloj nga lartë-poshtë, majtas-djathas.



Pas ndarjes Parcela bazë P-71914059-00125-0 kalon në arkiv

7.4 Krijimi i parcelës nga bashkimi

Bashkimi i parcelave kadastrale përbëhet nga të dhënat më të reja mbi parcelat dhe nga një tërësi formularësh të poshtëshënuar.

Procesi i bashkimit të parcelave është specifikuar në rastet në vijim:

7.4.1 Bashkimi i parcelave me pronar të njejtë

Në rastet kur parcelat, të cilat do t'i nënshtrohen procesit të bashkimit kanë koordinatat të matura atëherë së pari bëhet bashkimi i parcelave në zyrë, dhe përgatitet lënda për dorëzim në ZKK.

Në rastet kur bashkimi i parcelave bëhet sipas gjendjes faktike e cila shfrytëzohet në terren, atëherë gjeodeti duhet së pari të bëjë matjen e gjendjes faktike. Pasi që të bëhet matja, duhet të përpunohen të dhënat dhe të njëjtat të krahasohen me kufirin e parcelave bazë. Nëse gjeodeti konstaton që ka ndryshime për kufirin e parcelave që do të bashkohen në mes të të dhënave nga terreni me ato zyrtare - atëherë vlejnë analizat dhe korrigjimi i përcaktuar nga nënkapitulli 7.1.

7.4.2 Bashkimi i parcelave me pronar të ndryshëm

Në rastet kur kërkohet të bashkohen prona me pronarë të ndryshëm, krijimi i bashkëpronësisë bëhet vetëm në parcelën e formuar me bashkim, e cila duhet të krijohet paraprakisht me dokument të plotfuqishëm nga organi kompetent. Këto parcela fillimisht duhet të kenë statustin të matura, të kalojnë fazën e matjes dhe korrigjimit.

Lëndën për bashkimin e parcelave me pronarë të ndryshëm gjeodeti e dorëzon në ZKK në të njëjtën kohë me dokumentin e plotfuqishëm për krijimin e bashkëpronësisë të përpiluar nga organi kompetent, e cila duhet të trajtohet si një lëndë. Nëse bashkimi përfshinë krijimin e parcelës urbane kërkohet të jetë pëlqimi nga organi kompetent.

7.4.3 Bashkimi i parcelave me kultura të ndryshme

Në rastet kur kemi kërkesë për bashkimin e parcelave me kultura të ndryshme, ky bashkim lejohet por vetëm duhet të ruhen kulturat e parcelave siç kanë qenë para bashkimit. E njëjta kronologji duhet të ruhet edhe pas parcelimit të të njëjtës.

7.4.4 Bashkimi i parcelave me të drejta të ndryshme të pronësisë

Bashkimi i parcelave me të drejta të ndryshme pronësore bëhet në bazë të dokumentit të vlefshëm juridik me të cilin është paraparë e drejta e krijimit të bashkëpronësisë dhe bashkimi i parcelave me të drejta të ndryshme, të përpiluar dhe vërtetuar nga organi kompetent. Parcela e re e formuar do të ketë të drejta të ndryshme pronësore proporcionalisht me ato që i kanë pas parcelat e bashkuara.
Krijimi i bashkëpronësisë të së drejtës së qirambajtjes me të drejta tjera, bëhet vetëm për kohën e caktuar të qirambajtjes. Të gjitha ndërtesat e ndërtuara mbi të njëjtën parcelë pas bashkimit, i bartën të njëjtat të drejta si në parcelë me % e regjistruara në parcelë.


7.4.5 Bashkimi i parcelave në zonat me komasacion

Bashkimi i parcelave lejohet për parcelat në Komasacion.
Parcelat e reja që krijohen në zonat me komasacion duhet të ruajnë funksionin e parcelës e cila është subjekt i ndryshimit. Pra, parcelat e reja që krijohen duhet të kenë çasje në rrugët ekzistuese dhe forma e parcelave të reja duhet të jetë konform parcelës bazë.

7.4.6 Numërimi i parcelave të reja pas procesit të bashkimit

Në rastet e bashkimit të dy apo më shumë parcelave, numri i parcelës së re nga procesi i bashkimit fitohet duke i shtuar një (+1) numrit të fundit të parcelës në kuadër të zonës kadastrale e cila është në bazën e të dhënave në pjesën tekstuale.

Për ta ilustruar mund të marrim shembull bashkimin e parcelës P-71914059-00125-0 dhe P-71914059-00126-0, pas krijimit të njësisë së re, nëse numri i fundit në kuadër të zonës është P-71914059-01890-0 atëherë numri për parcelën e krijuar do të jetë +1, pra P-71914059-01891-0.



7.5 Formati dhe përmbajtja e lëndës për krijimin e parcelës

Lënda e cila dorëzohet në ZKK për azhurnim duhet të ketë këtë përmbajtje:

1. Mbështjellësi i lëndës (shtojca 3),

2. Lista e dokumenteve:

a. Kërkesa e parashtruar nga njëri nga palët e përcaktuar në kapitullin 5,
b. Dëshmia e burimit të të dhënave zyrtare të lëshuara nga ZKK apo AKK në formë elekontronike apo fizike,
c. Dëshmia e pagesës për të dhënat e pranuara nga ZKK apo AKK,
d. Fatura e lëshuar nga gjeodeti-kompania gjeodezike lidhur me shërbimet kadastrale sipas Udhëzimeve Administrative nr.12/2024,
e. Procesverbali nga terreni ku specifikohet matja, përshkrimi i gjendjes faktike dhe nënshkruhet nga palët e përcaktuar në kapitullin 5, apo me një konfirmim përmes e-mail-it, i cili duhet të bashkangjitet në procesverbal (të cilët paraprakisht duhet të njoftohen për procedurën) (shtojca 4),
f. Manuali i njësisë kadastrale për parcelë (shtojca 5),
g. Regjistri i ndërrimeve për parcelë (shtojca 6),
h. Lista e koordinatave të matura për parcelë (shtojca 7),
i. Formulari i korrigjimit të sipërfaqes, në rastet kur ka ndërrim të sipërfaqes (shtojca 8),
j. Manuali, konstatimi për korrigjim nëse ka korrigjim në pjesën grafike, sipas nënkapitullit 7.1, (shtojca 34)
k. Letërnjoftimi apo pasaporta e parashtruesit të kërkesës,

3. Raporti teknik (shtojca 9),

4. Të gjitha dokumentet e cekura më lartë pasi të vulosen dhe nënshkruhen duhet
të skanohen dhe ruhen si PDF dosje. PDF dosja emërtohet me numrin e protokollit të lëndës,

5. Lista e të dhënave në formatin digjital;

a. Fajlli origjinal i matjeve,
b. Lista e koordinatave në excel file,
c. Regjistri i ndërrimeve në excel file,
d. Të dhënat grafike për njësitë e reja në njërin nga formatet digjitale (dwg, shapefile, gml) dhe
e. PDF dosja e skanuar.

Në konfirmimin e-mail duhet të jenë të shënuara të dhënat personale të palës, njoftimi i tërësishëm i gjeodetit/kompanisë mbi procedurën që po zhvillohet, paraqitja e gjendjes së vjetër dhe gjendjes së krijuar, ku pala duhet të konfirmoj/jep miratimin për pranim të gjendjes.

7.6 Raporti teknik për krijimin e parcelës

Raporti teknik (shtojca 9) në faqen e parë duhet të përmbajë të dhënat e gjeodetit apo kompanisë gjeodezike e cila e ka hartuar lëndën, të dhënat e njësisë kadastrale *(komuna, zona kadastrale dhe numri i njësisë)*, përshkrimi i llojit të lëndës, datën dhe vendin.

Në raport duhet të përshkruhet komplet procesi i punës i cili është bërë për lëndën në fjalë, duke filluar prej parashtrimit të kërkesës nga pala, në cilësinë e kujt ka qenë pala aplikuese e deri te përfundimi i lëndës.

Nëse ka pasur ndryshim në gjendjen faktike, kufijtë e vjetër, nëse është bërë korrigjim i kufirit apo sipërfaqes, të përshkruhet se si është realizuar analiza e të dhënave pas të cilës është konstatuar se për parcelën në fjalë duhet të bëhet korrigjimi i kufirit apo sipërfaqes. Nëse gjatë procedurës ka ndryshim të kulturës, apo fshirje të ndërtesës në bazë të gjendjes faktike. Përcaktimi i ndarjes sipas gjendjes faktike, e planifikuar apo me leje nga drejtoria përkatëse për paisje me leje ndërtimore.

Duhet të përshkruhet metoda e matjeve, lloji i instrumentit i cili është përdor për matje, pikat kontrolluese të shfrytëzuara për realizimin e matjeve, matjet e pikave të dyfishta, si dhe sfidat eventuale gjatë realizimit të matjeve në terren, gjegjësisht gabimin e parcelës në pjesën grafike apo tekstuale, trajtimi sipas *(shtojcës 34)*, pikat që janë matur dhe nëse kanë mbetur pa u matur të paraqitet arsyetimi, etj.
Statusi i njësisë kadastrale në bazë të matjes duhet të përcaktohet a është apo jo "e matur". Nëse kërkesa është parashtruar fizikisht apo në mënyre elektronike dhe nëse për atë procedurë nuk ka qenë pala prezente aplikimi i konfirmimit për vazhdim të procedurës.

Gjithashtu duhet të paraqiten në formë tabelore të dhënat për njësinë e cila i është nënshtruar ndarjes, duke paraqitur sipërfaqen para ndarjes si dhe njësitë e reja të cilat janë krijuar *(numrin e parcelës dhe sipërfaqen m^2)*.

7.7 Manuali për krijimin e parcelës

Manuali (shtojca 5) për krijimin e njësive kadastrale nga procesi i regjistrimit fillestar/ndarjes/bashkimit duhet të ketë përmbajtjen dhe karakteristikat si më poshtë:

1. Parcelat në manual paraqiten në pozicionin e saktë sipas koordinatave, në njërën nga shkallët e zvogëlimit. Parcelat në manual janë të orientuara drejt veriut,
2. Kufiri i vjetër i njësisë kadastrale paraqitet me ngjyrë të zezë,
3. Kufiri i ri i njësisë kadastrale paraqitet me ngjyrë të kuqe,
4. Pikat e reja të kufirit numërohen me numra nga 1 deri N dhe paraqiten me ngjyrë të kuqe,
5. Pikat e vjetra të kufirit numërohen me numra 1 deri N paraqiten me ngjyrë të zezë,
6. Numri i ri i njësisë kadastrale paraqitet me ngjyrë të kuqe,
7. Numri i vjetër i njësisë kadastrale paraqitet me ngjyrë të zezë dhe me një vijë të kuqe përmes numrit,
8. Në manual paraqiten numrat e parcelave fqinje me ngjyre të zezë,
9. Në rastet kur parcela kufizohet me rrugë, lum, hekurudhë etj, përveç numrit duhet të ceket p.sh. emri i rrugës, emri i lumit etj. Në rastet kur nuk mund të specifikohet emri atëherë bëhet vetëm përshkrimi (hekurudhë, përrua etj),
10. Ndërtesat e regjistruara në regjistrin e pronave të paluajtshme, të cilat figurojnë në kopje të planit, por gjatë matjeve nuk ekzistojnë në terren, atëherë në manual shënohet “X” me ngjyrë të kuqe në numër të ndërtesës dhe në vijat e bazamentit të ndërtesës, apo ndërtesës si kulturë. Gjeodeti/kompania gjeodezike duhet të përshkruaj që ndërtesa është rrënuar dhe e njëjta duhet të fshihet nga regjistrat kadastral,
11. Manuali për krijimin e njësive kadastrale printohet me ngjyra në letër të bardhë në formatet A4 ose A3 dhe
12. Në manual duhet të parqitet shkalla e zvogëlimit në paraqitjen më të mirë (kjartë) të mundshme që mundëson paraqitjen e përmbajtjes së përshkruar.

7.8 Manuali për korrigjimin e kufijve të parcelës

Manuali *(shtojca 37)* për korrigjimin e parcelës duhet të ketë përmbajtjen dhe karakteristikat si më poshtë:


1. Parcelat në manual paraqiten në pozicionin e saktë sipas koordinatave të marra nga ZKK/AKK, në njërën nga shkallët e zvogëlimit. Parcelat në manual janë të orientuara drejt veriut,
2. Kufiri i vjetër i njësisë kadastrale paraqitet me ngjyrë të zezë,
3. Kufiri i ri i njësisë kadastrale paraqitet me ngjyrë të kuqe,
4. Pikat e reja të kufirit të cilat duhet të korrigjohen numërohen me numra të përkohshëm nga 1 deri N dhe paraqiten me ngjyrë të kuqe,
5. Pikat e vjetra të kufirit që mbesin të pa korrigjuara numërohen me numra të përkohshëm nga 1 deri N dhe paraqiten me ngjyrë të zezë,
6. Pikat e vjetra të cilat eleminohen duhet të anulohen me vijë të kuqe,
7. Në manual paraqiten numrat e parcelave fqinje me ngjyre të zezë,
8. Në rastet kur parcela kufizohet me rrugë, lum, hekurudhë etj, përveç numrit duhet të ceket p.sh. emri i rrugës, emri i lumit etj. Në rastet kur nuk mund të specifikohet emri atëherë bëhet vetëm përshkrimi (hekurudhë, përrua etj),
9. Ndërtesat e regjistruara në regjistrin e pronave të paluajtshme, të cilat figurojnë në kopje të planit, por gjatë matjeve nuk ekzistojnë në terren, atëherë në manual shënohet "X" me ngjyrë të kuqe në numër të ndërtesës dhe në vijat e bazamentit të ndërtesës, apo ndërtesës si kulturë. Gjeodeti/kompania gjeodezike duhet të përshkruaj që ndërtesa është i rrënuar dhe i njëjti duhet të fshihet nga regjistrat kadastral,
10. Manuali për krijimin e njësive kadastrale printohet me ngjyra në letër të bardhë në formatet A4 ose A3 dhe
11. Në manual duhet të parqitet shkalla e zvogëlimit në paraqitjen më të mirë (qartë) të mundshme që mundëson paraqitjen e përmbajtjes së përshkruar.

8 Kthimi i numrit të vjetër të parcelës

Numri i parcelës së vjetër i cili është anuluar dhe konsiderohet si i arkivuar, nuk mund të përdoret më, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

- Në rastet kur kemi të bëjmë me vendimet nga proceset e de-shpronësimit, dhe kthimi i sipërfaqës duhet të bëhet me shënimet e mëparshme, bëhet arkivimi i parcelës së gjertanishme dhe kthimi i asaj të mëparshme, lënda duhet të ketë studim të veçantë,

- Në rastet kur kemi të bëjmë me një vendim të shkallës së dytë ose një vendim gjykate për anulim të regjistrimit dhe kthim të gjendjes së vjetër.



9 Ndërrimi i kulturës së parcelës

Ndërrimi i kulturës së tokës bujqësore mund të bëhet vetëm në pajtim me planin e rregullimit hapësinor dhe dispozitat tjera të përcaktuara me Ligj.

Për tokat bujqësor me klasa 1-4 dhe 5-6 nuk mund t'i ndërrohet kultura nëse për atë rajon nuk është nxjerr plani hapësinor, gjegjësisht plani zhvillimor komunal me të cilin kësaj toke i është përcaktuar destinim tjetër.

Kurse për klasat 7-8 të tokës bujqësore, nëse nuk është i bazuar në planin e rregullimit hapësinor, do të bëhet me pëlqim urbanisitik.
Pëlqimin urbanisitik e jep organi kompetent për planifikim hapësinor në pajtim me pëlqimin e organit kompentent komunal për bujqësi.

Kërkesa për ndryshim të kulturave të tokave pyjore shtetërore dhe private bëhet në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Nëse toka bujqësore gjendet brenda kufijve të planit hapësinor procedura administrative për ndryshimin e kulturës fillon me kërkesë të palës të përcaktuar në kapitullin 5. Kërkesa dorëzohet në komunë në të cilën gjendet toka bujqësore përkatëse dhe i drejtohet organit përgjegjës për planifikim. Organi kompetent mund të jep pëlqim dhe zbatimi bëhet në dy mënyra:

- Nëse parcela e krijuar i ndryshohet vetëm kultura, mirret pëlqimi nga organi kompetent për ndryshimin dhe për të njëjtën nuk ka nevojë për matje, por vetëm regjistrim në ZKK.

- Nëse për ndryshimin e kulturës organi kompetent e jep pëlqimin vetëm për një pjesë të parcelës, kërkesa bëhet te gjeodeti për krijimin e njësisë e cila duhet të krijohet sipas pëlqimit dhe me dorëzimin e lëndës për krijimin e njësisë bëhet edhe ndryshimi i kulturës.

10 Caktimi i kufijve të parcelës

Me caktim të kufijve të parcelës nënkuptojmë shënimin e kufijve në bazë të shënimeve kadastrale me mënyrat dhe metodat e përcaktuara në këtë udhëzues. Me kërkesë të pales, të përcaktuar në kapitullin 5, tek gjeodeti, i njëjti parashtron kërkesë për shënime në ZKK.

Për të gjitha rastet e caktimit të kufijve palët fqinje duhet të njoftohen për procesin nga ana e gjeodetit. Nëse palët nuk i përgjigjen ftesës vazhdon procesi me një vërejtje për prezencën/mos prezencën e tyre. Formati i ftesës dhe procesverbalit është i përcaktuar në (shtojcën 11).

Ftesa duhet të afishohet në objektin më të afërt të parcelës dhe në parcelë, jo më pak se 5 ditë para caktimit të kufirit, me shënimet e caktuara në ftesë (shtojca 11).

Në rastet kur parashtruesi i kërkesës për caktim të kufijve siguron prezencën e fqinjëve, atëherë nuk kufizohet koha për ftesë dhe caktim të kufirit.

Në rastet kur caktohen koordinatat e parcelës, të cilat koordinata janë të matura atëherë bëhet caktimi i tyre në terren pa ndonjë procedurë paraprake të kontrollit.

Në rastet kur koordinatat e pikave nuk janë të matura, para fillimit të procesit të caktimit të pikave të parcelave, duhet të bëhet matja e gjendjes faktike nëse ajo ekziston. Pasi që të bëhet matja duhet të përpunohen të dhënat dhe të njëjtat të krahasohen me kufirin e parcelës dhe pjesën tekstuale. Nëse gjeodeti konstaton që ka ndryshime në mes të të dhënave në terren për kufirin e parcelës që do të caktohet me të dhënat nga pjesa grafike, dhe ndryshimet janë brenda tolerancës së përcaktuar në nënkapitullin 7.1, atëherë së pari duhet të bëhet korrigjimi në pjesën grafike në bazë të matjeve në terren dhe pastaj të vazhdohet me piketim. Ndryshimet në pjesën grafike bëhen nga ZKK, pas dorëzimit të procesverbalit të caktimit/identifikimit dhe korrigjimi i të dhënave grafike në të cilin ceket analiza në bazë të cilës ka arritur konstatimi për ndryshime (shtojca 11 dhe 34) nga gjeodeti apo kompania gjeodezike. Dorëzimi i raportit bëhet pas shënimit të gjendjes.

Në rastet kur nuk ka gjendje faktike për kufirin e parcelës që do të bëhet caktimi i pikave të parcelës, gjeodeti së pari duhet të bëjë kontrollin e të dhënave në pjesën grafike me hartat kadastrale (të vjetra), skica, skica të kashëruara, fotoskica, manual, fletore takeometrike apo çfarëdo shënime tjera që gjinden dhe pjesën tekstuale, nëse ka ndryshime dhe të njëjtat janë brenda nënkapitullit 7.1, atëherë bëhet korrigjimi i të dhënave në pjesën grafike për kufijtë e parcelave që do të piketohen, dorëzohet raporti (shtojca 11 dhe 34) në ZKK për korrigjim të të dhënave dhe pastaj bëhet caktimi i tyre.

ZKK është e obliguar që pas dorëzimit të lëndës së kompletuar nga gjeodeti të bëjë ndryshimet në regjistrat kadastral, për të cilën duhet të nxjerret aktvendim. Për një njësi kadastrale vetëm një herë mund të korrigjohen të dhënat.

10.1 Formati dhe përmbajtja e lëndës për krijimin e parcelës

Procesverbali nga terreni i nënshkruar nga palët i përcaktuar në kapitullin 5 i parcelave të trajtuara apo me një konfirmim përmes e-mail, i cili duhet të bashkangjitet në procesverbal (të cilët paraprakisht duhet të njoftohen për procedurën)

Procesverbali i caktimit përmban:
1. Të dhënat e gjeodetit/kompanisë gjeodezike,
2. Data dhe koha e caktimit,
3. Numri i protokollit të kërkesës,
4. Mënyra e matjeve,
5. Emri dhe mbiemri i aplikuesit,
6. Emri dhe mbiemri i palëve të pranishme,
7. Raporti i punës së caktimit të pikave,
8. Teksti "procesverbali u lexohet të gjitha palëve që morën pjesë gjatë caktimit",
9. Deklaratat e palëve nëse ata kanë kundërshtime,
10. Nënshkrimet e palëve të pranishme dhe
11. Emrin, mbiemrin si dhe nënshkrimi i gjeodetit të licencuar që ka kryer caktimin.

Në konfirmimin e-mail duhet të jenë të shënuara të dhënat personale të palës, njoftimi i tërësishëm i gjeodetit/kompanisë mbi procedurën që po zhvillohet, paraqitja e gjendjes, ku pala duhet të konfirmoj/jep miratimin për pranim të gjendjes.
Në procesverbalin e caktimit të kryer, në pjesën që lidhet me rezultatin e caktimit në terren, bëhet një përshkrim/raport i shkurtër i rrjedhës së veprimeve të kryera në procesin e caktimit, në varësi të llojit të matjeve në terren.

Raporti përmban:
1. Përshkrim të shkurtër të metodës së zgjedhur të matjes gjeodezike dhe procedurës së punës,
2. Pikat e përdorura nga rrjeti referent,
3. Të dhënat kadastrale të përdorura: planet, skicat, manualet, fletore takeometrike,
4. Krahasimi i të dhënave kadastrale me situatën në terren dhe
5. 5Saktësinë e matjeve.

Një kopje e procesverbalit i dorëzohet palës pas përfundimit të caktimit. *(shtojca 11)*.

11 Procesi i ri - rregullimit të kufirit të parcelës

Ri-rregullimi i kufirit të parcelës bëhet me kërkesë të njërit nga pronarët e parcelave që janë kufitar për pjesën ku do të bëhet ri-rregullimi i kufirit. Kërkesa parashtrohet tek gjeodeti apo kompania gjeodezike. Së bashku me kërkesën pala duhet të dorëzojë:

1. Dokumentin identifikues kopje.

Gjeodeti apo Kompania gjeodezike pas pranimit të kërkesës nga njëri nga parashtruesit e përcaktuar në kapitullin 5, bënë kërkesën në ZKK për marrjen e të dhënave si më poshtë:

1. Kufirin e parcelave të cilat janë subjekt i ri-rregullimit të kufirit në njërin nga formatet digjitale (dwg, shapefile, gml) dhe
2. Koordinatat e pikave të kufirit në excel, të printuar dhe të vulosura.

Pas marrjes së të dhënave nga ZKK, duhet të fillohet me matjen e gjendjes faktike në terren të të gjitha pikave të reja dhe të vjetra (përjashtimisht atyre për shkaqe tjera nuk mund të maten sipas pikës 7.1). Në terren matet kufiri i cili prezantohet nga të dy kufitarët, të cilët duhet të jenë prezent gjatë matjes. Ri-rregullimi varet nga ndryshimi i sipërfaqes së fituar nga matja e gjendjes faktike në terren me atë të të dhënave zyrtare nga pjesa grafike.

Varësisht nga sipërfaqja e parcelës, është përcaktuar edhe përqindja e lejuar për ndryshim të sipërfaqes:

1. Për parcelat me sipërfaqe deri 100 m², korrigjimi i sipërfaqes së parcelës bazë përmes procesit të ri-rregullimit mund të bëhet deri në 10%,
2. Për parcelat me sipërfaqe nga 100 m² deri në 250 m², korrigjimi i sipërfaqes së parcelës bazë përmes procesit të ri-rregullimit mund të bëhet deri në 8%,
3. Për parcelat me sipërfaqe nga 251 m² deri në 500 m², korrigjimi i sipërfaqes së parcelës bazë përmes procesit të ri-rregullimit mund të bëhet deri në 5%,
4. Për parcelat me sipërfaqe prej 501 m² deri në 2500 m², korrigjimi i sipërfaqes së parcelës bazë përmes procesit të ri-rregullimit mund të bëhet deri në 4%,
5. Për parcelat me sipërfaqe nga 2501 m² deri në 5000 m², korrigjimi i sipërfaqes së parcelës bazë përmes procesit të ri-rregullimit mund të bëhet deri në 3% dhe
6. Për parcelat me sipërfaqe mbi 5000 m², korrigjimi i sipërfaqes së parcelës bazë përmes procesit të ri-rregullimit mund të bëhet deri në 2%.

Toleranca llogaritet pas korrigjimit të sipërfaqes grafike dhe tekstuale.

Shembulli 1: në rastin kur subjekt i ri-rregullimit të kufirit janë dy parcela, 4-1 me sipërfaqe 99 m² dhe parcela 4-2 me sipërfaqe 320 m², dhe ndryshimi i kufirit bëhet brenda parcelës 4-1, atëherë sipërfaqja që mund të ndryshohet duhet të jetë më e vogël ose e barabartë me 9.9 m² (10% e parcelës me sipërfaqe 99 m²).

Shembulli 2: në rastin kur subjekt i ri-rregullimit të kufirit janë dy parcela, parcela 11-0 me sipërfaqe 730 m² dhe parcela 12-0 me sipërfaqe 430 m², dhe ndryshimi i kufirit bëhet në dy parcelat 11-0 dhe 12-0, atëherë sipërfaqja që mund të ndryshohet brenda parcelës 11-0 duhet të jetë më e vogël ose e barabartë me 29.2 m² (4% e parcelës me sipërfaqe 730 m²) ndërsa brenda parcelës 12-0 duhet të jetë më e vogël ose e barabartë me 21.5 m² (5% e parcelës me sipërfaqe 430 m²).

Shembulli 3: në rastin kur subjekt i ri-rregullimit të kufirit janë dy parcela, 9-0 me sipërfaqe 2300 m² dhe parcela 10-1 me sipërfaqe 220 m², dhe ndryshimi i kufirit bëhet brenda parcelës 10-1-0, atëherë sipërfaqja që mund të ndryshohet duhet të jetë më e vogël ose barabartë me 17.6 m² (8% e parcelës me sipërfaqe 220 m²).

Në të gjitha rastet, ri-rregullimi i kufirit në mes të dy parcelave, gjegjësisht i njëjti kufi mund të realizohet vetëm një herë.
Ri-rregullimi është i ndaluar në rastet kur ndërrohet pozita dhe forma e parcelave që i nënshtrohen këtij procesi.

Në rastet kur përmes procesit të ri-rregullimit, ndryshimi i sipërfaqes i kalon kufizimet e përqindjeve të cekura më lartë, pozitën apo formën, atëherë për ato raste duhet të shkohet me ndarje apo bashkim e ndarje të parcelave.

11.1 Formati dhe përmbajta e lëndës

Lënda e cila dorëzohet në ZKK për azhurnim duhet të ketë këtë përmbajtje:

1. Mbështjellësi i lëndës (shtojca 3),
2. Lista e dokumenteve:
   a. Kërkesa e parashtruar nga njëri nga palët e caktuar në kapitullin 5,
   b. Dëshmia e burimit të të dhënave zyrtare të lëshuara nga ZKK apo AKK,
   c. Dëshmia e pagesës për të dhënat e pranuara nga ZKK apo AKK,
   d. Fatura e lëshuar nga gjeodeti apo kompania gjeodezike lidhur me shërbimet kadastrale sipas UA 12/2024 Procesverbali nga terreni i nënshkruar nga palët e përcaktuar në kapitullin 5 e parcelave të trajtuara, apo me një konfirmim përmes e-mail, i cili duhet të bashkangjitet në procesverbal (të cilët paraprakisht duhet të njoftohen për procedurën) (shtojca 4),
   e. Manuali i ri-rregullimit të kufirit të njësive kadastrale (shtojca 12),
   f. Regjistri i ndërrimeve (shtojca 6),
   g. Lista e koordinatave të matura (shtojca 7),
   h. Formulari i korrigjimit të sipërfaqes në rastet kur ka ndërrim të sipërfaqes (shtojca 8),
   i. Manuali, konstatimi për korrigjim nëse ka korrigjim në pjesën grafike, sipas nënkapitullit 7.1 dhe
   j. Letërnjoftimet apo pasaportat e pronarëve,
3. Raporti teknik i ri-rregullimit (shtojca 13),
4. Të gjitha dokumentet e cekura më lartë pasi të vulosen dhe nënshkruhen duhet të skanohen dhe ruhen si dosje PDF. Dosja PDF emërtohet me numrin e protokollit të lëndës,
5. Lista e të dhënave në formatin digjital:
   a. Fajlli origjinal i matjeve,
   b. Lista e koordinatave në file excel,
   c. Regjistri i ndërrimeve (fletëparaqitjeve) në file excel,
   d. Të dhënat grafike për njësitë e reja në njërin nga formatet digjitale (dwg, shapefile, gml) dhe
   e. Dosja PDF e skanuar.

11.1.1 Raporti teknik

Raporti teknik i ri-rregullimit (shtojca 13) në faqen e parë duhet të përmbajë të dhënat e gjeodetit apo kompanisë gjeodezike, e cila ka hartuar lëndën, të dhënat e njësisë kadastrale (komuna, zona kadastrale dhe numri i njësisë), përshkrimi i llojit të lëndës, datën dhe vendin.

Në raport duhet të përshkruhet komplet procesi i punës, i cili është bërë për lëndën në fjalë, duke filluar prej parashtrimit të kërkesës nga pala, në cilësinë e kujt e ka parashtruar kërkesën e deri te përfundimi i lëndës.

Duhet të përshkruhet metoda e matjeve, lloji i instrumentit i cili është përdorë për matje, pikat kontrolluese të shfrytëzuara për realizimin e matjeve, si dhe sfidat eventuale gjatë realizimit të matjeve në terren, gjegjësisht gabimin e parcelës në pjesën grafike apo tekstuale, trajtimi sipas shtojcës 34, pikat që janë matur dhe nëse kanë mbetur pa u matur duhet të paraqitet arsyetimi.

Statusi i njësisë kadastrale në bazë të matjes duhet të përcaktohet a është apo jo “e matur”, nëse kërkesa është parashtruar fizikisht apo në mënyre elektronike dhe nëse për atë procedurë nuk ka qenë pala prezente aplikimi i konfirmimit.

Nëse ka pasur ndryshim në gjendje faktike, kufijtë e vjetër, nëse është bërë korrigjim i kufirit apo sipërfaqes, të përshkruhet se si është realizuar analiza e të dhënave pas të cilës është konstatuar se për parcelën në fjalë duhet të bëhet korrigjimi i kufirit apo sipërfaqes, nëse gjatë procedurës ka ndryshim të kulturës, apo fshirje të ndërtesës në bazë të gjendjes faktike.

Të paraqiten në formë tabelare të dhënat për njësinë e cila i është nënshtruar ri-rregullimit të kufirit, duke paraqitur sipërfaqen para ri-rregullimit si dhe sipërfaqet pas ri-rregullimit të kufirit.

11.1.2 Manuali për ri-rregullim

Manuali *(shtojca 12)* për ri-rregullim të kufirit duhet të ketë këtë përmbajtje:

1. Parcelat në manual paraqiten në pozicionin e saktë sipas koordinatave, në njërën nga shkallët e zvogëlimit. Parcelat në manual janë të orientuara drejt veriut,
2. Kufiri i vjetër i njësisë kadastrale paraqitet në skicë me ngjyrë të zezë,
3. Kufiri i ri i njësisë kadastrale paraqitet me vijë me ngjyrë të kuqe,
4. Vija kufitare e vjetër e njësisë kadastrale e cila ndryshohet apo anulohet, mbulohet me "X" me ngjyrë të kuqe në pjesën e vijës kufitare,
5. Pikat e reja të kufirit numërohen me numra të përkohshëm nga 1 deri në N dhe paraqiten me ngjyrë të kuqe,
6. Numri i parcelës me ngjyrë të zezë,
7. Në skicë paraqiten numrat e parcelave fqinj, me ngjyre të zezë,
8. Në rastet kur parcela kufizohet me rrugë, lum, hekurudhë etj., përveç numrit duhet të ceket p.sh. emri i rrugës, emri i lumit në rastet tjera vetëm përshkrim (hekurudhë, përrua etj),
9. Ndërtesat e regjistruara në regjistrin e pronave të paluajtshme të cilat figurojnë në kopje të planit, por gjatë matjeve nuk ekzistojnë në terren, atëherë në manual shënohet "X" me ngjyrë të kuqe në numër të ndërtesës dhe në vijat e bazamentit të ndërtesës. ZKK në bazë të procedurave obligohet ta fshijë nga regjistri,
10. Manuali printohet me ngjyra në letër të bardhë në formatet A4 ose A3, dhe
11. Në manual duhet të parqitet shkalla e zvogëlimit në paraqitjen më të mirë (kjartë) të mundshme që mundëson paraqitjen e përmbajtjes së përshkruar.

12 Identifikimi i njësive kadastrale

Me qëllim të identifikimit të një njësie kadastrale (parcelë, ndërtesë ose një pjesë e ndërtesës) nga ZKK lëshohen të dhënat si vijon:

1. Certifikata e pronësisë,
2. Kopja e planit me vërejtje në rast të mungesës së shënimeve,
3. Skica e njësisë kadastrale me koordinata dhe
4. Skica e ndërtesës ose një pjese të ndërtesës, përkatësisht një pjesë nga dokumentacioni teknik (planimetria e katit në të cilën gjendet pjesa e ndërtesës).

Identifikimi i parcelave mund të bëhet në dy mënyra, me matje dhe pa matje në terren.
Nëse identifikimi nuk mund të realizohet në zyre, bazuar në të dhëna kadastrale, identifikimi realizohet me procedurën e caktimit.


Për parcelat të cilat mungojnë në pjesën grafike mund të përdoren rastet e përcaktimit të kufirit por, varësisht nga rasti, identifikimi mund të bëhet në këto mënyra:
1. Rasti i parë – identifikimi i parcelës që mungon në pjesën grafike.
Fillimisht duhet të matet gjendja e cila prezantohet nga pronari apo shfrytëzuesi. Duhet të krijohet procesverbali në të cilin duhet të nënshkruajnë pronari i parcelës dhe fqinjët të cilët mund të jenë pronar apo posedues faktik me të cilët kufizohet parcela e cila është në proces të identifikimit, me anë të të cilit procesverbal palët e konfirmojnë se kufiri i cili është prezantuar për matje është kufiri i cili edhe shfrytëzohet dhe respektohet nga të gjithë, si dhe sipërfaqja e cila është derivat i matjes së gjendjes faktike regjistrohet në RDPP;
2. Rasti i dytë – në rastet kur gjendet manuali i ndarjes së parcelës i cili i ka koordinatat e pikave të parcelave, atëherë këto pika vetëm duhet të transformohen në Kosoveref01, të caktohen në terren dhe të njoftohen palët me kufirin, i cili azhurnohet në pjesën grafike nga ZKK-ja;
3. Rasti i tretë - nëse gjendet ndonjë hartë kadastrale, pjesë e hartës apo skicë në të cilën është paraqitur ndryshimi i parcelës dhe e njëjta mungon në pjesën grafike, kurse pjesa tekstuale është regjistruar, atëherë bëhet matja e gjendjes faktike dhe këto ndryshime azhurnohen në pjesën grafike nga ZKK-ja;
4. Rasti i katërt - nëse gjendet ndonjë hartë kadastrale në të cilën janë të paraqitura ndryshime të mëdha dhe të njëjtat mungojnë në pjesën grafike, atëherë duhet të bëhet digjitalizimi i hartës dhe këto ndryshime të azhurnohen në pjesën grafike. Ndryshimet në këto raste bëhen vetëm nga AKK-ja.

Për të gjitha këto identifikime palët e pakënaqura nuk mund të ndalojnë azhurnimin e kufirit në regjistra kadastral, por që kanë të drejtë ankese në ZKK apo AKK pasi kufiri të azhurnohet në kadastër.

Nëse për parcelën kadastrale ka kërkesë të ndarjes dhe në të njëjtën parcelë ka mungesë të shënimeve grafike, atëherë fillimisht duhet të bëhet identifikimi i parcelave që mungojnë, apo parcelimi duhet të shoqërohet me nënshkrimin e fqinjëve kufitar të parcelës së re të krijuar.

Pas identifikimit, matjeve dhe pranimit të gjendjes faktike, kompletohet lënda e cila dorëzohet në ZKK për azhurnim në RDPP, kur për të njëjtën ka edhe ndryshime tjera, e njëjta lëndë dorëzohet dhe trajtohet si një lëndë.

Edhe për identifikim vlen mënyra e njëjtë e paraqitjes së kërkeses dhe pranimit të gjendjes përmes konfirmimit.



13 Korrigjimi i sipërfaqeve të parcelave

Korrigjimi i sipërfaqes mund të bëhet vetëm kur mund të maten të gjitha pikat e parcelës (përjashtimisht atyre që janë përcaktuar në nënkapitullin 7.1 që nuk mund të maten).
Në momentin kur të gjitha koordinatat mund të maten, derivat i tyre është një sipërfaqe e cila duhet edhe të regjistrohet në regjistra kadastral e njëjtë si në pjesën grafike, për të cilën nuk ka nevojë miratim të fqinjve.

Më poshtë janë specifikuar rastet dhe procedurat për korrigjimin e sipërfaqes së njësive kadastrale gjatë aktiviteteve të ndryshme, që nëse nuk kanë matje duhet të kalojnë në procesin e përcaktuar te nënkapitulli 7.1:

1. Në rastet kur bëhet caktimi i pikave në terren dhe palët pajtohen me gjendjen pas caktimit të pikave, atëherë sipërfaqja që është derivat i atyre pikave duhet të korrigjohet në pjesën tekstuale,
2. Në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me ndarje, bashkim, identifikim, rirregullim kur plotësohen kriteret teknike të specifikuara, atëherë bëhet korrigjimi i sipërfaqes në pjesën tekstuale duke u marrë për bazë sipërfaqja e parcelave që marrin statusin e parcelave të matura,
3. Pas konstatimit nga matja se sipërfaqja e parcelës që është subjekt i trajtimit ka mospërputhje më të mëdha, atëherë ZKK është e obliguar që t'i ofrojë gjeodetit të dhëna shtesë grafike dhe tekstuale, për të gjitha parcelat fqinje sipas kërkesës së gjeodetit, që ky i fundit të mund të bëjë analizën dhe korrigjimin e atyre të dhënave. Këto të dhëna mund të shfrytëzohen vetëm për qëllim të studimit të lëndës.

Në procesverbalet e terrenit, e përcaktuar në kapitullin 5, palët nënshkruajnë që pajtohen me pikat definitive kufitare të vendosura në terren nga të cilat edhe derivohet sipërfaqja definitive që regjistrohet në RDPP (shtojca 4).
Po ashtu gjeodeti apo kompania gjeodezike duhet t'i bashkangjesë lëndës edhe formularin për korrigjimin e sipërfaqes (shtojca 8), i cili nënshkruhet dhe vuloset vetëm nga gjeodeti.

Për mos përputhjet më të mëdha të sipërfaqeve duhet fillimisht të kryhen matje të të gjitha pikave që janë të mundshme për analizë edhe të kufijve të parcelave përreth. Të krahasohen të dhënat në mes të pjesës tekstuale dhe grafike, gjendja faktike, manual , skicë apo plan kadastral. Në raport teknik duhet të ceken të gjitha ndryshimet dhe rrjedhoja e tyre për vendosje të lëndës për aprovim të korrigjimit.

14 Krijimi i ndërtesës si njësi kadastrale

Bazuar në nenin 20, paragrafi 2, të Ligjit për kadastër të pronës së paluajtshme Nr. 08/L-237, ndërtesa është njësi e veçantë kadastrale.

14.1 Para regjistrimi i ndërtesës dhe pjesëve të ndërtesave

Para regjistrimi i ndërtesës dhe pjesëve të ndërtesës në regjistra kadastral bëhet sipas lejes ndërtimore në përputhje me Ligjin përkatës për Ndërtim.

Para regjistrimi i ndërtesës dhe pjesëve të ndërtesës bëhet me status të veçantë dhe regjistrimi/shënimi do të jetë i veçantë.

Formati i numrit të ndërtesës përmban shkurtesën O (Objektit) para kodit të zonës kadastrale dhe numrin e njësisë p.sh. O-71914059-155-0.

Rregullat e numërimit dhe krijimit vlejnë si të ndërtesës dhe pjesëve të ndërtesës në mënyrë të rregullt si regjistrim fillestar. Njësia do të ketë certifikatë të veçantë dhe emërtim ndërtesë/pjesë e ndërtesës së para-regjistruar.

Të njëjtat njësi do të jenë pjesë e transaksioneve juridike dhe regjistrime të të drejtave.
Shtojca e para regjistrimit është e përcaktuar në shtojcën 16.

Kërkesa për para-regjistrim të ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës përmban:

- Kërkesën e palëve të përcaktuar në kapitullin 5 apo investitori,
- Leja ndërtimore,
- Raporti gjeodezik i cili duhet te përmbaj paraqitjen grafike të bazës së ndërtesës dhe secilës pjesë të ndërtesës me koordinata,
- Regjistri i fletëparaqitjeve për ndërtesën dhe pjesët e ndërtesës me përshkrimet e përcaktuar në regjistër dhe
- Marrëveshjen për investim të përbashkët dhe aneksi i marrëveshjes për investim të përbashkët i përpiluar te noteri dhe i nënshkruar nga të gjitha palët, i cili përpilohet në bazë të regjistrit sipas pikës “e” në këtë kapitull.

Njësia kadastrale – ndërtesë/pjesë e ndërtesës përmban këto të dhëna:

1. Komunën,
2. Numrin unik dhe emrin e zonës kadastrale,
3. Numrin e parcelës/ numrin e ndërtesës,
4. Numrin e ndërtesës/pjesës së ndërtesës
5. Kufirin e ndërtesës/ pjesës së ndërtesës,
6. Etazhitetin e ndërtesës,
7. Adresën e ndërtesës/pjesës së ndërtesës,
8. Sipërfaqen,
9. Të dhënat për pronarin dhe/apo shfrytëzuesin e regjistruar dhe
10. Shfrytëzimin

Para regjistrimi në regjistrin kadastral është i barasvlefshëm me afatin e lejës së ndërtimit të lëshuar nga organi kompetent.

Në rast të revokimit të lejes nga ana e autoriteve kompetente i njëjti autoritet duhet të bëjë kërkesë në ZKK për fshirje të para-regjistrimit apo pronari/investitori mund të parashtroj kërkesës për fshirje të para-regjistrimit duke i bashkangjitur kërkesës anulimin/revokimin e lejës ndërtimore nga organi kompetent.

14.2 Matja e ndërtesës

Matja e ndërtesës bëhet duke matur minimum tri pika me instrumente gjeodezike, ndërsa pikat tjera mund edhe të krijohen duke matur frontet me distancë matës apo ndonjë metodë tjetër, e cila duhet të ceket.

Për përgatitjen e lëndës për regjistrim në SIKTK, matja bëhet në pikat thyerëse të shputës së themelit të ndërtesës apo ndërtesa pa fasad. Saktësia e matjeve është e specifikuar në kapitullin për matjet kadastrale.

Përveç shputës së ndërtesës duhet të maten edhe të gjitha katet tjera të cilat ndryshojnë nga forma e shputës së themelit të ndërtesës *(shputa e bodrumit, shputa e suterenit, shputa e përdheses dhe kateve tjera karakteristike).*

14.2.1 Numrimi i ndërtesës

Numri i ndërtesës është unik në kuadër të një zone kadastrale.
Numërimi i ndërtesës në kuadër të zonës kadastrale bëhet duke filluar nga 1 deri në n. Formati i numrit të ndërtesës përmban shkurtesën O (Objekt) para kodit të zonës kadastrale dhe numrin e njësisë p.sh. O-71914059-155-0.

Në rastet kur në kuadër të një zone kadastrale ka të regjistruara ndërtesa, atëherë çdo ndërtesë e re merr numrin e fundit brenda një zone kadastrale plus një (+1), p.sh. nëse numri i fundit i ndërtesës në kuadër të një zone kadastrale është O-71914059-155-0 atëherë numri i ri i ndërtesës është plus një (+1), pra O-71914059-156-0.

14.2.2 Formati dhe përmbajta e lëndës për regjistrim të ndërtesës në regjistrin kadastral

Lënda e cila dorëzohet në ZKK për azhurnim duhet të ketë këtë përmbajtje:

1. Mbështjellësi i lëndës (shtojca 3),
2. Lista e dokumenteve:
    a. Kërkesa e parashtruar nga pronari apo investitori,
    b. Fatura e lëshuar nga gjeodeti dhe kompania gjeodezike lidhur me shërbimet kadastrale sipas UA 12/2024,
    c. Manuali për ndërtesë me pjesë të ndërtesave (shtojca 14),
    d. Manuali i njësisë kadastrale ndërtesë (shtojca 15),
    e. Regjistri i ndërrimeve për ndërtesë me pjesë të ndërtesave (shtojca 16),
    f. Regjistri i ndërrimeve për ndërtesë (shtojca 17),
    g. Lista e koordinatave (shtojca 18),
    h. Marrëveshjen për investim të përbashkët,
    i. Leja ndërtimore,
    j. Certifikata e përdorimit,
    k. Aneksi i marrëveshjes për investim të përbashkët i përpiluar te noteri dhe nënshkruar nga të gjitha palët, i cili përpilohet në bazë të regjistrit sipas pikës e në këtë kapitull,
    l. Letërnjoftimi apo certifikata e biznesit të parashtruesit të kërkesës,
    m. Dokumente tjera që parashihen me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi dhe
    n. Certifikata e adresës.
3. Raporti teknik (shtojca 9),
4. Të gjitha dokumentet e cekura më lartë pasi të vulosen dhe nënshkruhen duhet të skanohen dhe ruhen si dosje PDF. Dosja PDF emërtohet me numrin e protokollit të lëndës,
5. Lista e të dhënave në formatin digjital:
    a. Fajlli origjinal i matjeve,
    b. Lista e koordinatave në excel file,
    c. Regjistri i ndërrimeve në excel file,
    d. Të dhënat grafike për njësitë e reja në njërin nga formatet digjitale (dwg, shapefile, gml) dhe
    e. PDF dosja e skanuar sipas pikës 4.

14.2.3 Raporti teknik

Raporti teknik për regjistrimin e ndërtesës (shtojca 9) në faqen e parë duhet të përmbajë të dhënat e gjeodetit apo kompanisë gjeodezike, e cila ka hartuar lëndën, të dhënat e njësisë kadastrale (komuna, zona kadastrale dhe numri i njësisë), përshkrimi i llojit të lëndës, datën dhe vendin.

Në raport duhet të përshkruhet komplet procesi i punës, i cili është bërë për lëndën në fjalë, duke filluar prej parashtrimit të kërkesës nga pala, në cilësinë e kujtë e deri të përfundimi i lëndës.

Duhet të përshkruhet metoda e matjeve, lloji i instrumentit i cili është përdorë për matje, si dhe sfidat eventuale gjatë realizimit të matjeve në terren.

14.2.4 Manuali për ndërtesë

Manuali *(shtojca 14 dhe 15)* për krijimin e njësisë kadastrale ndërtesë duhet të ketë këtë përmbajtje:

1. Ndërtesat në manual paraqiten në pozicionin e saktë sipas koordinatave, në njërën nga shkallët e zvogëlimit. Ndërtesat në manual janë të orientuara drejt veriut,
2. Kufiri i njësisë kadastrale parcelë paraqitet në skicë me ngjyrë të zezë,
3. Njësia kadastrale ndërtesë paraqitet me vijë me ngjyrë të kuqe,
4. Pikat e ndërtesës numërohen me numra të përkohshëm nga 1 deri n dhe paraqiten me ngjyrë të kuqe,
5. Numri i ri i njësisë kadastrale paraqitet me ngjyrë të kuqe,
6. Ndërtesat e regjistruara në regjistrin e pronave të paluajtshme dhe të cilat figurojnë në kopje të planit, por gjatë matjeve nuk ekzistojnë në terren, atëherë në manual shënohet “X” me ngjyrë të kuqe në numër të ndërtesës dhe në vijat e bazamentit të ndërtesës. ZKK në bazë të procedurave obligohet ta fshijë nga regjistri,
7. Manuali për krijimin e njësisë kadastrale printohet me ngjyra në letër të bardhë në formatet A4 ose A3 dhe
8. Manuali për krijimin e njësive kadastrale duhet të paraqitet në shkallë të zvogëlimit në paraqitjen më të mirë (kjartë) të mundshme që mundëson paraqitjen e përmbajtjes së përshkruar.

14.3 Regjistri i ndërtesës

Kërkesa për regjistrimin e ndërtesës paraqitet nga:

- **Pronari i tokës** apo
- **Investitori i ndërtimit** sipas marrëveshjes për bashkë ndërtim të vërtetuar tek organi kompetent.

Kërkesa për regjistrimin e ndërtesës, e cila përmban edhe pjesët e saj, duhet të përfshijë edhe regjistrimin e njësive kadastrale si pjesë e ndërtesës dhe hapësirat e përbashkëta.
Investitori apo pronari i tokës obligohet që në marrëveshjen mbi investimin e përbashkët të rregulloj marrëdhëniet pronësore në parcelë me titullarin: Bashkëpronësi në Ndërtesë në Pjesët e Përbashkëta për Njësitë e Veçanta.

Nuk mund të regjistrohet njësia e re kadastrale për ndërtesën kolektive dhe pjesën e ndërtesës para se të regjistrohet parcela dhe ndërtesa si bashkëpronësi e pronarëve të pjesës së ndërtesës, të cekur si më lartë.
Regjistrimi i ndërtesës individuale dhe asaj kolektive (me njësi) mund të bëhet vetëm pas marrjes së certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent, përjashtimisht për ndërtesat kolektive të ndërtuara para vitit 1999.
Sipërfaqja nga matjet kadastrale duhet të jetë e njëjtë me lejen e ndërtimit (sipas legjislacionit në fuqi).

Regjistri i ndërtesës është format zyrtar në të cilin paraqiten të dhënat e nevojshme për ndërtesën e cila do të regjistrohet në RDPP.

Regjistri i ndërtesave individuale përmban këto të dhëna:

1. Komuna,
2. Zona kadastrale,
3. Numri i njësisë kadastrale të ndërtesës,
4. Numri i kateve të ndërtesës,
5. Sipërfaqja e kateve (m^2) – Sipërfaqja për secilin kat,
6. Sipërfaqja e shputës (m^2) – sipërfaqja e shputës së ndërtesës,
7. Adresa e ndërtesës – emri i rrugës dhe numri i adresës në të cilën ka qasje ndërtesa, të dhënat për adresën mund të merren në drejtorinë e urbanizmit, e cila lëshon certifikatën e adresës ose edhe nga Gjeoportali shtetëror (http://geoportal.rks-gov.net),
8. Vendi i quajtur,
9. Shfrytëzimi aktual i ndërtesës, sipas lejes ndërtimore
10. Pronari/shfrytëzuesi – plotësohen të dhënat për pronarin/shfrytëzuesin (emri, emri i prindit dhe mbiemri), nëse aplikuesi është biznes atëherë plotësohen të dhënat e kompanisë,

11. Numri personal – nëse aplikuesi është person fizik atëherë plotësohet me të dhënat e numrit personal, nëse aplikuesi është kompani atëherë plotësohet me të dhënat e numrit të unifikuar të biznesit dhe
12. Pjesa e pronësisë.

Regjistri i ndërtesave me pjesë të ndërtesave përmban këto të dhëna:

1. Komuna,
2. Zona kadastrale,
3. Numri i njësisë kadastrale të ndërtesës,
4. Sipërfaqja (m^2) – sipërfaqja e shputës së ndërtesës,
5. Lloji i ndërtesës,
6. Shfrytëzimi aktual i ndërtesës, sipas lejes ndërtimore
7. Numri i kateve të ndërtesës,
8. Adresa e ndërtesës – emri i rrugës dhe numri i adresës në të cilën ka qasje ndërtesa. Të dhënat për adresën mund të merren në drejtorinë e urbanizmit, e cila lëshon certifikatën e adresës ose edhe nga Gjeoportali shtetëror (http://geoportal.rks-gov.net),
9. Vendi i quajtur,
10. Leja ndërtimore – numri i lejes ndërtimore,
11. Pronari/shfrytëzuesi – plotësohen të dhënat për pronarin/shfrytëzuesin (emri, emri i prindit dhe mbiemri), nëse aplikuesi është biznes atëherë plotësohen të dhënat e kompanisë,
12. Numri personal – nëse aplikuesi është person fizik atëherë plotësohet me të dhënat e numrit personal, nëse aplikuesi është kompani atëherë plotësohet me të dhënat e numrit të unifikuar të biznesit,
13. Adresa e pronarit dhe
14. Pjesa e pronësisë.

14.4 Ndarja e ndërtesës

Ndarja e ndërtesës realizohet duke bërë matje në terren. Nga realizimi i këtyre matjeve krijohen njësi të reja të ndërtesës. Vija ndarëse e cila është bazë për ndarje të ndërtesës i ndan edhe të gjitha katet të cilat janë të regjistruara, si dhe ndryshohet numërimi i të gjitha njësive si pjesë të ndërtesës.
Për realizimin e procesit të ndarjes së ndërtesës duhet që të prezantohet leja për ndarje e lëshuar nga organet kompetente.

Numërimi i ndërtesës pas ndarjes është i përcaktuar. Për ta ilustruar këtë do të marrim shembullin e ndarjes së ndërtesës me numër O-71914059-155-0, në dy pjesë.

Njësit e reja që do të krijohen do të marrin këta numra O-71914059-155-1 dhe O-71914059-155-2.
Në shtojcën numër 19 është prezantuar formati për ndarjen e një ndërtese.

14.5 Bashkimi i ndërtesave

Njësia e re kadastrale ndërtesë, mund të krijohet edhe nga bashkimi i dy apo më shumë ndërtesave.

Bashkimi i ndërtesave në këto raste realizohet pa bërë matje në terren. Vija ndarëse e cila ka ekzistuar para bashkimit, që ka qenë bazë për ndarje të ndërtesës largohet ndërsa me procesin e bashkimit të ndërtesave, bashkohen edhe të gjitha katet të cilat janë të regjistruara si dhe ndryshohet numërimi i të gjitha njësive në kuadër të ndërtesës.
Për realizimin e procesit të bashkimit të ndërtesës duhet që të prezantohet leja e veçantë e lëshuar nga organet kompetente që lejon bashkimin e ndërtesës.
Bashkimi i ndërtesave bëhet edhe me të drejta të ndryshme, ku ndërtesa e re apo pjesa e ndërtesës së re të formuar do të ketë të drejta të ndryshme pronësore proporcionalisht me ato që i ka pasë ndërtesa apo pjesa e ndërtesës së bashkuar.

Numërimi i ndërtesës pas bashkimit është i përcaktuar. Për ta ilustruar këtë do të marrim shembullin e bashkimit të dy ndërtesave, ndërtesës me numër O-71914059-155-0 dhe O-71914059-156-0. Njësia e re që do të krijohet merr numrin e fundit të ndërtesës në kuadër të zonës plus një (+1), pra nëse ndërtesa e fundit e regjistruar ka numrin O-71914059-350-0 atëherë numri i njësisë së re të krijuar pas bashkimit do të jetë O-71914059-351-0.
Në shtojcën numër 20 është prezantuar formati për bashkimin e ndërtesave.

14.6 Ndërrimi i destinimit të ndërtesës

Nëse destinimi i ndërtesës nga pronari është ndryshuar, apo dëshiron të ndryshohet, atëhere i njëjti duhet të pajiset me leje nga organi kompetent për ndryshimin e kërkuar. Pas marrjes së lejes së përdorimit nga organi kompetent nëse për të njëjtën njësi nuk ka ndryshime tjera, kërkesa dorëzohet në ZKK për ndryshimin e përdorimit të ndërtesës, por që për të njëjtën ka kërkesë për ndryshime tjera (ndarje, bashkim) lënda kompletohet dhe dorëzohet përmes gjeodetit/komapnisë gjeodezike.

14.7 Fshirja e ndërtesës së rrënuar

Nëse një ndërtese e shënuar në regjistra kadastral me numër të veçantë apo si kulturë ndërtimore (shtëpi, ndërtesë, lokal, etj) e njëjta në gjendjen faktike është rrënuar tërësisht ajo duhet të fshihet në regjistrat kadastral. Nëse pozicioni i saj nuk është e paraqitur në pjesën grafike, atëhere kërkohen plane apo manual si është krijuar.

Fshirja e ndërtesës bëhet:

- Sipas detyrës zyrtare- nëse organi kompetent dërgon njoftimin në ZKK për rrënimin e ndërtesës, apo
- Kur gjeodeti gjatë aktivitetit kadastral në terren (matjes për një lëndë të caktuar) konstaton se ndërtesa nuk ekziston në terren, në momentin e dorëzimit të lëndës duhet të bëjë edhe përshkrimin e statusit të ndërtesës dhe sipërfaqja e kulturës ndërtesës mbetet në sipërfqen e kulturës ndërtimore.

Pronari duhet të njoftohet për fshirjen e ndërtesës.



15 Krijimi i pjesës së ndërtesës si njësi kadastrale

Bazuar në nenin 20, paragrafi 2, të Ligjit për kadastër të pronës së paluajtshme Nr. 08/L-237, pjesa e ndërtesës është njësi e veçantë kadastrale.

Njësia kadastrale – pjesë e ndërtesës përmban:
1. Komunën,
2. Numri unik dhe emrin e zonës kadastrale,
3. Numrin e parcelës,
4. Numrin e ndërtesës,
5. Numrin e pjesës së ndërtesës,
6. Kufirin e pjesës së ndërtesës,
7. Sipërfaqen,
8. Të dhënat për pronarin dhe/apo shfrytëzuesin e regjistruar dhe
9. Shfrytëzimin.

15.1 Matja e pjesës së ndërtesës

Matja e pjesës së ndërtesës bëhet duke përdorur instrumente për matje distancë-matës apo metërshirit. Matja duhet të realizohet duke matur të gjitha frontet kufizuese të pjesës së ndërtesës, e cila pastaj duhet të pozicionohet saktë bazuar në ndërtesë.
Matja për pjesën e ndërtesës, e cila llogaritet ka në përbërje: hapësirat e shfrytëzueshme për banim apo afarizëm, muret e brendshme, terasat që lidhen me njësinë, muret me fqinjët për gjysmë, muret e jashtme të plota (pa fasadë), muret nga koridoret të plotë.

15.1.1 Numërimi i pjesës së ndërtesës

Numri i njësisë kadastrale – pjesë e ndërtesës është unik.

Formati i njësisë kadastrale–pjesë e ndërtesës është i standardizuar dhe përmban O-71914059-155-1-1-0. Shkronja O paraqet ndërtesën, numri 71914059-paraqet numrin e zonës kadastrale, numri 155 paraqet numrin e ndërtesës, numrin 1 paraqet numrin e hyrjes dhe numrin 1-0 paraqet numrin e pjesës së ndërtesës.

Numërimi i pjesëve të ndërtesës bëhet nga e majtë në të djathtë duke filluar nga kati ku ndodhet hyrja në ndërtesë.

Pjesa e ndërtesës identifikohet me numrin e ndërtesës. Në rastet kur ndërtesa ka më shumë se një hyrje atëherë numërimi i hyrjeve bëhet nga e majta në të djathtë duke filluar nga 1 deri në n. Numërimi i ndërtesës me dy hyrje përmban këtë format: O-71914059-155-1 dhe O-71914059-155-2

Pjesët e ndërtesës do të numërohen në këtë mënyrë:

1. Pjesët e ndërtesës prej nivelit të përdhesës e lartë do të numërohen prej numrin 1 deri në n, pra p.sh. O-71914059-155-1-1-0 ...O-71914059-155-1-n-0;
2. Pjesët e ndërtesës prej suterenit nga niveli më i ulët e lartë e (një e më shumë nivele) do të numërohen prej numrin S1 deri në Sn, pra p.sh. O-71914059-155-1-S1-0 ... O-71914059-155-1-Sn-0;
3. Pjesët e ndërtesës nën nivelin e përdhesës apo suterenit e poshtë do të numërohen prej numrit 1 deri në n, duke i shtuar parashtresën B secilës njësi kadastrale që gjendet nën përdhesë apo suteren si p.sh. O-71914059-155-1-B1-0... O-71914059-155-1-Bn-0;

Pjesët e ndërtesës si Duplex dhe Penthause duhet të ju shënohet sipërfaqja e përgjithshme, kurse në kolona të veçanta të ndahet për duplex (secili kat me sipërfaqe), kurse për penthause (sipërfqja e banimit veç, sipërfaqja e terrasës veç). Për njësitë që kanë në përmbajtje garazhë dhe depo bashkë ndahen sipërfaqet dhe shfrytëzimet veç e veç për secilin brenda njësisë së njëjtë.

15.1.2 Formati dhe përmbajta e lëndës

Lënda e cila dorëzohet në ZKK për azhurnim duhet të ketë këtë përmbajtje:

1. Mbështjellësi i lëndës (shtojca 3),
2. Lista e dokumenteve,
3. Kërkesa e parashtruar nga pronari apo i autorizuari i pronarit, investitori apo i autorizuari i investitorit,
4. Fatura e lëshuar nga gjeodeti apo kompania gjeodezike lidhur me shërbimet kadastrale sipas UA 12/2024
5. Manuali i njësisë kadastrale pjesë e ndërtesës (shtojca 21),
6. Regjistri i ndërrimeve (shtojca 16),
7. Lista e koordinatave (shtojca 22),
8. Marrëveshjen për investim të përbashkët,
9. Leja ndërtimore,
10. Certifikata e përdorimit,
11. Aneksi i marrëveshjes për investim të përbashkët i përpiluar te noteri dhe nënshkruar nga të gjitha palët, i cili përpilohet në bazë të regjistrit sipas pikës “e” në këtë kapitull,

12. Letërnjoftimi apo certifikata e biznesit të parashtruesit të kërkesës,
13. Dokumente tjera që parashihen me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi dhe
14. Raporti teknik (shtojca 9).

Të gjitha dokumentet e cekura më lartë pasi të vulosen dhe nënshkruhen duhet të skanohen dhe ruhen si dosje PDF. Dosja PDF emërtohet me numrin e protokollit të lëndës.

Lista e të dhënave në formatin digjital:
1. Lista e koordinatave në file excel,
2. Regjistri i ndërrimeve në file excel,
3. Të dhënat grafike për njësitë e reja në njërin nga formatet digjitale (dwg, shapefile, gml),
4. Dosja PDF e skanuar.

15.1.3 Raporti teknik

Raporti *(shtojca 9)* në faqen e parë duhet të përmbajë të dhënat e gjeodetit apo kompanisë gjeodezike të licencuar e cila ka hartuar lëndën, të dhënat e njësisë kadastrale (komuna, zona kadastrale dhe numri i njësisë), përshkrimi e llojit të lëndës, datën dhe vendin.

Në raport duhet të përshkruhet komplet procesi i punës i cili është bërë për lëndën në fjalë, duke filluar prej parashtrimit të kërkesës nga pala e deri te përfundimi i lëndës.

Duhet të përshkruhet metoda e matjeve, numri i njësive banesore në kuadër të ndërtesës, lloji i tyre si dhe sfidat eventuale gjatë realizimit të lëndës.

15.1.4 Manuali për pjesë të ndërtesës

Manuali (shtojca 21) për krijimin e njësive kadastrale – pjesë të ndërtesës duhet të ketë këtë përmbajtje:
1. Pjesët e ndërtesës në manual paraqiten në pozicionin e saktë sipas koordinatave, në njërën nga shkallët e zvogëlimit. Pjesët e ndërtesës në manual janë të orientuara drejt veriut, (shtojca 21)
2. Pikat e pjesës së ndërtesës numërohen me numra të përkohshëm nga 1 deri n,
3. Numri i njësisë kadastrale,
4. Hapësirën e shkallëve me vija të ndërprera,

5. Pozicioni i ashensorit,
6. Dyert e pjesëve të ndërtesave,
7. Në regjistrin e koordinatave të paraqitura në manual duhet të jetë i paraqitur edhe kati,
8. Manuali për krijimin e njësisë kadastrale printohet me ngjyra në letër të bardhë në formatet A4 ose A3 dhe
9. Manuali për krijimin e njësive kadastrale duhet të parqitet në shkallë të zvogëlimit në paraqitjen më të mirë (kjartë) të mundshme që mundëson paraqitjen e përmbajtjes së përshkruar.

15.2 Regjistri i pjesës së ndërtesës

Regjistri i ndërtesës është format zyrtar, në të cilin paraqiten të dhënat e nevojshme për pjesët e ndërtesës të cilat do të regjistrohen në RDPP, i cili përmban këto të dhëna:

1. Komuna,
2. Zona kadastrale,
3. Numri i njësisë kadastrale të ndërtesës,
4. Sipërfaqja (m^2) – e shputës së ndërtesës
5. Lloji i ndërtesës,
6. Adresa e ndërtesës – emri i rrugës dhe numri i adresës në të cilën ka qasje ndërtesa, të dhënat për adresën mund të merren në drejtorinë e urbanizmit, e cila lëshon certifikatën e adresës ose edhe nga Gjeoportali shtetëror (http://geoportal.rks-gov.net),
7. Vendi i quajtur,
8. Leja ndërtimore – Nëse ndërtesa ka leje ndërtimore atëherë kjo fushë plotësohet me numrin e lejes,
9. Pronari/shfrytëzuesi – plotësohen të dhënat për pronarin/shfrytëzuesin (emri, emri i prindit dhe mbiemri), nëse aplikuesi është biznes atëherë plotësohen të dhënat e kompanisë,
10. 1Numri personal – nëse aplikuesi është person fizik atëherë plotësohet me të dhënat e numrit personal, nëse aplikuesi është kompani atëherë plotësohet me të dhënat e numrit të unifikuar të biznesit,
11. Adresa e pronarit dhe
12. Pjesa e pronësisë.

Në pjesën e dytë përshkruhen të dhënat për pjesët e ndërtesës dhe janë këto kolona që duhet të plotësohen:

1. Numri i njësisë kadastrale - pjesë e ndërtesës,
2. Hyrja,
3. Kati,
4. Sipërfaqja (m²), *e shputës së pjesës së ndërtesës (e përcaktuar te nënkapitulli 15.1),*
5. Adresa e ndërtesës – *emri i rrugës dhe numri i adresës në të cilën ka qasje ndërtesa, të dhënat për adresën mund të merren në drejtorinë e urbanizmit, e cila lëshon certifikatën e adresës ose edhe nga Gjeoportali shtetëror (http://geoportal.rks-gov.net),*
6. Vendi i quajtur,
7. Shfrytëzimi aktual – *plotësohen të dhënat lidhur me shfrytëzimin aktual të njësisë kadastrale (p.sh. banesë, lokal, garazhë apo depo),*
8. Numri i dhomave- *për banesat përshkrimi i numrit të dhomave,*
9. Pronari/shfrytëzuesi – *plotësohen të dhënat për pronar/shfrytëzues: emri, emri i prindit dhe mbiemri, nëse aplikuesi është biznes atëherë plotësohen të dhënat e kompanisë,*
10. Numri personal – *nëse pronari është person fizik atëherë plotësohet me të dhënat e numrit personal, nëse pronari është person juridik atëherë plotësohet me të dhënat e numrit të unifikuar të biznesit,*
11. Pjesa e pronësisë dhe
12. Adresa e pronarit.

15.3 Ndarja e pjesës së ndërtesës

Pjesa e ndërtesës mund të ndahet duke krijuar njësi të reja të pjesës së ndërtesës.

Ndarja e pjesës së ndërtesës realizohet duke bërë matje. Nga realizimi i këtyre matjeve krijohen njësi të reja pjesë të ndërtesës. Për realizimin e procesit të ndarjes së pjesës së ndërtesës duhet që të pajiset me leje nga organet kompetente.

Pas ndarjes së pjesës së ndërtesës O-71914059-155-2-1-0 pjesët e ndërtesës marrin numra të ri p.sh. O-71914059-155-2-1-1 dhe O-71914059-155-2-1-2.

15.4 Bashkimi i pjesëve të ndërtesave

Njësia e re kadastrale pjesë e ndërtesës mund të krijohet edhe nga bashkimi i dy apo më shumë pjesëve të ndërtesës.

Bashkimi i pjesëve të ndërtesës në këto raste realizohet pa bërë matje. Vija ndarëse e cila ka ekzistuar para bashkimit që ka qenë bazë për ndarje të pjesës së ndërtesës eleminohet. Për realizimin e procesit të bashkimit të ndërtesës duhet që të prezantohet leja e veçantë e lëshuar nga organet kompetente.

Pas bashkimit të pjesëve të ndërtesës, njësia e re e krijuar merr numër të ri, numri i fundit i pjesës së ndërtesës në kuadër të ndërtesës + 1.

15.5 Ri-rregullimi i kufirit të pjesës së ndërtesës

Ri-rregullimi si proces mund të bëhet edhe për pjesët e ndërtesës të regjistruara, të cilat kanë ndryshime në gjendjen faktike nga ajo në regjistra kadastral. Për të vazhduar si proces, lidhur me këtë ndryshim, duhet që pala fillimisht të bëjë kërkesë te organi kompetent që të merrë leje mbi ndryshimin e kërkuar. Gjeodeti do të përgatitë lëndën me matje dhe dokumentacionin përkatës për ndryshim. Përmbajtja dhe paraqitja e lëndës është në shtojcën 19. Ri-rregullimi i kufirit të pjesës së ndërtesës mund të bëhet vetëm një herë për atë kufi.

15.6 Ndryshimi i përdorimit të pjesës së ndërtesës

Nëse përdorimi i ndërtesës nga pronari është ndryshuar, apo dëshiron të ndryshohet, atëherë i njëjti duhet të pajiset me leje nga organi kompetent për ndryshimin e kërkuar. Pas marrjes së lejes nëse për të njëjtën njësi nuk ka ndryshime tjera, kërkesa dorëzohet në ZKK për ndryshimin e përdorimit të ndërtesës, por që për të njëjtën ka kërkesë për ndryshime tjera (ndarje, bashkim) lënda kompletohet dhe dorëzohet përmes gjeodetit/komapnisë gjeodezike.

16 Krijimi i njësive kadastrale për hapësirat e përbashkëta

Bazuar në ligjet relevante për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, hapësirat e përbashkëta duhet të regjistrohen si njësi të veçanta (pjesë e ndërtesës) kadastrale për secilin kat.

Hapësirat e përbashkëta të përcaktuara me ligje të veçanta si shkallët, ashensori, korridori etj. duhet të jenë të gjeoreferencuara në sistemin koordinativ Kosovaref01.

Për regjistrimin e hapësirave të përbashkëta për ndërtesat që kanë të regjistruar njësitë kadastrale – pjesët e ndërtesave kërkesa mund të realizohet nga njëri prej pronarëve të njësisë kadastrale në kuadër të ndërtesës dhe të njëjta duhet të regjistrohen gjatë regjistrimit të ndërtesës me pjesë të ndërtesës.

Numërimi i hapësirave të përbashkëta bëhet nga niveli me i ultë i ndërtesës (p.sh. bodrumi) deri te niveli më i lartë duke i shtuar parashtesën HP para numrit të njësisë, p.sh. O-71914059-155-2-HP1-0 ... O-71914059-155-2-HPn-0.



17 Rastet e veçanta të regjistrimit të ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave

Procesi dhe dokumentacioni gjeodezik dhe kadastral që nevojitet për regjistrimin e ndërtesës dhe pjesëve të ndërtesës në raste të veçanta janë të ndara për këto kategori:

1. Trajtimi i ndërtimeve pa leje,
2. Ndërtesat e ndërtuara para vitit 1999 dhe
3. Shtëpitë në cilësi të banesës.

17.1 Trajtimi i ndërtimeve pa leje

17.1.1 17.1.1 Matja e ndërtesës - Situacioni

Matja e ndërtesave bëhet duke matur minimum tri pika të dy brinjëve të gjata me instrumente për matje GNSS/Stacion Total, ndërsa pikat tjera duhet të krijohen duke matur frontet me distancë matës apo ndonjë metodë tjetër.
Në manualin që përpilon gjeodeti apo kompania gjeodezike përveç ndërtesës që trajtohet duhet të paraqiten edhe të dhënat si vijon:

1. Kyçja në rrjetin elektrik,
2. Kyçja në rrjetin e ujësjellësit,
3. Kyçja në rrjetin e ujërave të zeza,
4. Pjesa e ndërtesave fqinje të cilat janë të ndërtuara afër kufirit të parcelës apo afër ndërtesës të trajtuar,
5. Rrethoja (muri, rrethojë metalike etj),
6. Rrugët dhe
7. Adresa e ndërtesës (emri i rrugës dhe numri i ndërtesës), e cila identifikohet nga Gjeoportali shtetëror.

Në *shtojcën 23* është prezantuar formati i manualit për ndërtesat individuale.

17.1.2 Dëshmitë nga gjeoportali dhe fotot e ndërtesës

Në procesin e legalizimit është e specifikuar se ndërtesat që mund të trajtohen janë vetëm ato që janë të ndërtuara deri me 05 Shtator 2018, andaj dokumentacionit duhet t'i bashkangjitet edhe një skicë nga gjeoportali shtetëror, me të cilën dëshmohet që ndërtesa është e paraqitur në ortofoto të vitit 2018.

Në shtojcën numër 24 është prezantuar një shembull i dëshmisë nga gjeoportali për ndërtesë.

Gjatë matjes gjeodeti duhet të bëjë edhe fotografi për ndërtesën, të cilat duhet të bashkëngjiten në lëndën e cila dorëzohet në drejtorinë përkatëse në kuadër të komunës.

17.1.3 Përgatitja e skicave për kate

Në rastet e ndërtesave të banimit duhet të përgatiten skicat për secilin kat, në të cilat duhet të paraqitet gabariti i katit, duke përfshi edhe terasat. Në bazë të këtyre të dhënave do të llogaritet sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesës.

Në shtojcat numër 25, 26, 27 dhe 28 është prezantuar formati për përmbajtjen e manualit për katet e ndërtesës.

Për secilin kat duhet të përgatitet lista e koordinatave (shtojca 29) që duhet të përmbajë: numrin e pikave, koordinatat Y, X dhe kuotën e bazës së pllakës të katit përkatës H si dhe sipërfaqen e katit.

Nr.	Y	X	H	Etazhi	Sipërfaqja (m²)
B1	7511461.921	4720540.651	634.592	Kati 1	58.82
B2	7511467.563	4720540.424			
B3	7511467.224	4720529.682			
B4	7511462.181	4720529.920			
B5	7511462.317	4720532.871			
B6	7511461.662	4720532.914			

Table 2 . Lista e koordinatave për katet e ndërtesave të banimit

17.1.4 Përgatitja e të dhënave për dorëzim në Kadastër

Pas përpunimit të të dhënave përgatitet manuali sipas formatit zyrtar.

Nga të dhënat e fituara nga matjet në terren dhe përpunimi i tyre në zyre, përgatitet regjistri i ndërtesës.

Regjistri i ndërtesës është formati zyrtar në të cilin paraqiten të dhënat e nevojshme për ndërtesën e cila do të regjistrohet në SIKTK.

Regjistri përmban këto të dhëna:

1. Komuna,
2. Zona kadastrale,
3. Numri i njësisë kadastrale (ndërtesë),
4. Numri i kateve të ndërtesës (etazhiteti),
5. Sipërfaqja e kateve (m^2) – Sipërfaqja e secilit kat të ndërtesës,
6. Sipërfaqja (m^2) - e shputës së ndërtesës,
7. Adresa e njësisë kadastrale – emri i rrugës në të cilën ka qasje ndërtesa, të dhënat për adresën mund të merren nga Gjeoportali shtetërore (http://geoportal.rks-gov.net),
8. Vendi i quajtur,
9. Shfrytëzimi aktual,
10. Pronari – plotësohen të dhënat për pronarin (emri, emri i prindit dhe mbiemri), nëse aplikuesi është biznes atëherë plotësohen të dhënat e kompanisë,
11. Numri personal – nëse aplikuesi është person fizik atëherë plotësohet me të dhënat e numrit personal, nëse aplikuesi është kompani atëherë plotësohet me të dhënat e numrit të unifikuar të biznesit dhe
12. Pjesa e pronësisë.

Në shtojcën numër 16 dhe 17 është prezantuar formati i regjistrit të njësisë kadastrale - ndërtesë.

Formati i numrit të njësisë kadastrale ndërtesë është i standardizuar vetëm se në procesin e legalizimit përveç numrit të zonës kadastrale, numri i njësisë kadastrale plotësohet nga zyrtarët komunal, si p.sh. O-71914075-___-_

Në pjesën grafike për secilën ndërtesë (shtëpi banimi) duhet të azhurnohet edhe gabariti i secilit kat sipas të dhënave që janë cekur në pikën 17.1.3.

17.1.5 Njësit banesore / Ndërtesat e kategorisë së dytë

Matja e bazamentit për ndërtesat e kategorisë së dytë bëhet njëjtë si për kategorinë e parë, konkretisht si përshkrimi në pikën 17.1.1.

Në shtojcën numër 16 është prezantuar formati i regjistrit të njësisë kadastrale – ndërtesë dhe pjesëve të ndërtesës.

Dallimi i vetëm të kategoria e dytë është se për këtë kategori përgatiten të dhënat edhe për njësitë kadastrale pjesë të ndërtesës (banesa, lokale, garazha apo depo), ku skicat për njësit banesore si dhe regjistri për pjesë të ndërtesave ndryshon dhe kanë këtë përmbajtje:

Në pjesën e parë përshkruhen të dhënat për ndërtesën dhe janë këto kolona që duhet të plotësohen:

1. Komuna,
2. Zona kadastrale,
3. Numri i njësisë kadastrale të ndërtesës,
4. Sipërfaqja (m²) –e shputës së ndërtesës,
5. Lloji i ndërtesës,
6. Adresa e ndërtesës – emri i rrugës në të cilën ka qasje ndërtesa, të dhënat për adresën mund të merren nga Gjeoportali shtetëror (http://geoportal.rks-gov.net),
7. Vendi i quajtur,
8. Leja ndërtimore – Nëse ndërtesa ka leje ndërtimore atëherë kjo fushë plotësohet me numrin e lejes,
9. Pronari – plotësohen të dhënat për pronarin (emri, emri i prindit dhe mbiemri), nëse aplikuesi është biznes atëherë plotësohen të dhënat e kompanisë,
10. Numri personal – nëse aplikuesi është person fizik atëherë plotësohet me të dhënat e numrit personal, nëse aplikuesi është kompani atëherë plotësohet me të dhënat e numrit të unifikuar të biznesit,
11. Adresa e pronarit dhe
12. Pjesa e pronësisë.

Në pjesën e dytë përshkruhen të dhënat për pjesët e ndërtesës dhe janë këto kolona që duhet të plotësohen:

1. Numri i njësisë kadastrale - pjesë e ndërtesës,
2. Hyrja,
3. Kati,
4. Sipërfaqja (m²), e shputës së pjesës së ndërtesës (e përcaktuar te nënkapitulli 15.1),
5. Adresa e njësisë - emri i rrugës në të cilën ka qasje ndërtesa, të dhënat për adresën mund të merren nga gjeoportali shtetëror (http://geoportal.rks-gov.net),
6. Numri i adresës – numri i ndërtesës, të dhënat për adresën mund të merren nga Gjeoportali shtetëror (http://geoportal.rks-gov.net),
7. Vendi i quajtur,
8. Shfrytëzimi aktual,
9. Numri i dhomave- për banesat përshkrimi numrit të dhomave,
10. Pronari – plotësohen të dhënat për pronar: emri, emri i prindit dhe mbiemri, nëse aplikuesi është biznes atëherë plotësohen të dhënat e kompanisë,
11. Numri personal – nëse pronari është person fizik atëherë plotësohet me të dhënat e numrit personal, nëse pronari është person juridik atëherë plotësohet me të dhënat e numrit të unifikuar të biznesit,
12. Adresa e pronarit dhe
13. Pjesa e pronësisë.

17.2 Njësitë kadastrale ndërtesë me pjesë të ndërtesave të ndërtuara para vitit 1999

Në kuadër të rasteve të veçanta të regjistrimit të ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave, përveç procesit të legalizimit në vazhdim do të pasqyrohen edhe rastet e ndërtesave me pjesë të ndërtesave të ndërtuara para vitit 1999 si dhe shtëpitë në cilësi të banesës po ashtu të ndërtuara para vitit 1999.

Lejet e ndërtimit për ndërtesat në pronësi shoqërore të ndërtuara para vitit 1999 në shumë raste nuk ekzistojnë. Të gjitha këto ndërtesa konsiderohen se kanë poseduar lejen e ndërtimit nëse organet komunale nuk e vërtetojnë të kundërtën. Ortofotot e viteve 2000 e 2001 mund të përdoren në rastet kur ekziston dyshimi nëse ndërtesa vërtetë është ndërtuar para vitit 1999. Andaj për regjistrimin e këtyre ndërtesave veprohet njëjtë sikurse ndërtesat që posedojnë leje ndërtimi.

17.2.1 Shtëpitë në cilësi të banesës

Në rastet kur aplikohet për regjistrimin e shtëpisë në cilësi të banesës, të ndërtuara para vitit 1999, për të cilën posedohet kontratë e vërtetuar nga organet kompetente, atëherë ndërtesa identifikohet në terren, realizohen matjet dhe regjistrohet në kadastër.

Në rastet kur në kontratë të shitblerjes apo privatizimit është shënuar vetëm sipërfaqja e shfrytëzueshme (p.sh. vetëm dhomat), ndërsa ndërtesa e ndërtuar para 1999 ka sipërfaqe më të madhe (duke përfshirë banjo, kuzhinë, korridor) apo kur sipërfaqja e gjendjes faktike pas matjes së këtyre ndërtesave nuk përputhet me sipërfaqen nga kontrata e vërtetuar nga gjykata kompetente, atëherë vektorizohet ndërtesa nga planet kadastrale. Bëhet krahasimi në mes të poligonit/ sipërfaqes së vektorizuar nga plani dhe matjeve nga gjendja faktike, nëse ajo përputhet me sipërfaqen nga planet kadastrale, atëherë regjistrohet sipërfaqja e përgjithshme e ndërtesës pasi që konsiderohet si ndërtesë me leje, ndërsa nëse nuk përputhet (tejkalohet poligoni /sipërfaqja) në mes të vektorizimit nga plani dhe gjendja faktike, kjo pjesë trajtohet me procese tjera (p.sh. procesin e legalizmit).

18 Regjistrimet në bazë të aktgjykimeve

Për të gjitha krijimet e njësive kadastrale ky paragraf do të vlejë për përpilimin e ekspertizave nga nxjerrja e këtij udhëzuesi, për rastet kur lënda do të zbatohet në ZKK/AKK për ndryshime. Përmes ekspertizave të kryera nga gjeodeti, përmes të cilave nxjerret një aktgjykim i cili bëhet i plotëfuqishëm, i ekzekutueshëm, ato duhet të jenë të formatizuara që pala (fituesi i së drejtës) të mos ketë nevojë që lënda të përsëritet për regjistrim në kadastër.
Fillimi i procedurës së përpilimit të ekspertizës fillon me kërkesën e gjykatësit, ku gjeodeti merr të drejtën për nxjerrjen e dokumentacionit relevant për përgatitjen e ekspertizës.

Ekspertiza duhet të përmbajë dokuemnetet e përcaktuara si në kapitullin 7:

1. Manualin,
2. Koordinatat,
3. Regjistrin,
4. Raportin teknik dhe
5. Ekspertizën me konstatim (shtojca numer 35).

Poashtu gjeodeti duhet të dorëzoj ekspertizën (pjesën tekstuale dhe elemetet shtesë të kërkuar nga gjykatësi dhe palët në procedurë) *(shtojca numer 35).*

Aktgjykimi i plotëfuqishem dhe i ekzekutushem së bashku me eksperizën me të cilën është nxjerrë aktgjykimi zbatohen në regjistrin kadastral me kërkesë të palës apo gjeodetit.

Për zbatimin e aktgjykimit në ZKK dorëzohet një lëndë për trajtim, gjegjësisht krijim të njësisë dhe bartje të pronësisë.

19 Formati dhe përmbajta e të dhënave të ofruara nga ZKK-të

ZKK është e obliguar që në momentin e dorëzimit të të dhënave për njësinë kadastrale, të specifikojë statutin tyre (pikë nga vektori, pikë e matur, pikë nga fletoret takeometrike, etj).

Të dhënat që ZKK-të duhet t'i ofrojnë subjekteve të licencuar për shërbime gjeodezike janë:

a) Koordinatat e pikave të njësisë kadastrale në formatin excel dhe
b) Kufirin e njësisë kadastrale në njërin nga formatet digjitale (shape file, dwg, gml).

Koordinatat e pikave të njësisë kadastrale së bashku me skicën duhet të dorëzohen në mënyrë analoge të printuara, të nënshkruara dhe të vulosura dhe dixhitale përmes email zyrtar.

ZKK në momentin e dorëzimit të të dhënave sipas pikave të cekura me lartë, duhet të lëshojë edhe një dëshmi të vulosur dhe të nënshkruar në të cilën listohen të dhënat që janë dorëzuar. Nëse para dorëzimit të të dhënave të lartcekura vërehet ndonjë mospërputhje eventuale apo gabim në të dhëna atëherë duhet të bëhet kontrolli i kualitetit si vijon:

1. Të bëhet kontrolli i sipërfaqes në mes të bazës grafike dhe bazës tekstuale (SIKTK),
2. Të kontrollohet vektori me planin kadastral (raster) dhe sipas rasteve të bëhen korrigjimet e nevojshme,
3. Të kontrollohen planet kadastrale - kjo duhet të bëhet duke insertuar pikat e rendit të I-rë, rendit të II-të, rendit të III-të, pikat trigonometrike, pikat detale dhe lidhja e planeve në mes vete dhe
4. Në të gjitha rastet kur bëhen ndryshime të të dhënave, ZKK është e obliguar të bëjë edhe azhurnimin e statusit të njësisë kadastrale p.sh. njësi e matur apo e korrigjuar.

ZKK në afat prej tri ditësh duhet t'i përgjigjet gjeodetit për shënimet e kërkuara.

Me avancimin e sistemve kadastrale, mënyra dhe formati i të dhënave të dorëzuara nga ZKK dhe aplikimit për ndryshime nga gjeodetët/kompanitë gjeodezike do të ndryshoj, për të cilën do të krijohet një doracak.

20 Pranimi dhe kontrolli i lëndës nga ZKK dhe AKK

Pas dorëzimit të kërkesës nga gjeodeti, kompania gjeodezike apo personi zyrtar i certifikuar në institucionin publik përveç AKK-së dhe ZKK-së, ZKK/AKK është e obliguar të bëjë verifikim dhe kontrollin e lëndës.

Dorëzimi i kërkesës mund të bëhet me një lëndë: korrigjimi i pjesës grafike, korrigjimi i sipërfaqes, ndarja, bashkimi, identifikimi dhe ri-rregullimi.

Kontrolli i lëndës bëhet sipas listës së kontrollit (shtojca 30), ku secila lëndë duhet të jetë e kompletuar sipas kërkesave dhe standardeve në fuqi.
ZKK/AKK pas përfundimit të kontrollit, përgatit raportin për statusin e lëndës dhe nëse nuk ka mangësi fillon me azhurnimin në SIKTK në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas përfundimit të azhurnimit dhe regjistrimit njoftohet aplikuesi (gjeodeti, kompania gjeodezike apo personi zyrtar i certifikuar në institucionin publik përveç AKK-së dhe ZKK-së) se lënda është përfunduar.
Nëse lënda ka mangësi atëherë ZKK/AKK duhet t'i përshkruaj saktë llojin e gabimeve dhe të njoftoj palën ku kërkon që të bëhen plotësimet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Aktvendimi për pezullim i ZKK/AKK për gjeodetin, kompaninë gjeodete, duhet të ketë këtë përmbajtje:

- Numri i lëndës së protokollit të gjeodetit dhe protokollit nga ZKK/AKK dhe data,
- Të dhënat për subjektin e licencuar për shërbime gjeodezike,
- Mangësitë e identifikuara të jenë të specifikuara,
- Përcaktimi i afatit prej 15 ditëve për korrigjim dhe
- Përcaktimi i mënyrës së ankesës.

I njëjti aktvendim duhet t'i përcillet përmes email-it gjeodetit/komapnisë gjeodezike/ personi zyrtar i certifikuar në institucionin publik përveç AKK-së dhe ZKK-së, i cili poashtu lëndën mund ta plotësoj përmes email. Nëse brenda afatit të përmendur gjeodeti/komapnia gjeodezike/ personi zyrtar i certifikuar në institucionin publik përveç AKK-së dhe ZKK-së nuk i korrigjon dhe eliminon mangësitë e raportuara, atëherë ZKK/AKK përmes një vendimi refuzon kërkesën për ndryshimin e kërkuar.

Nëse gjeodeti, pas njoftimit nga ZKK/AKK i ka plotësuar të gjitha vërejtjet atëherë ZKK/AKK nuk ka të drejtë të paraqes vërejtje tjera.
AKK së paku një herë në vit bënë monitorimin e gjeodeteve të licencuar dhe kompanive gjeodezike të pajisura me leje. Monitorimi bëhet për lëndët e kryera nga subjektet e licencuara.

21 Korrigjimi i gabimeve për njësi kadastrale

Pas secilit monitorim, AKK përpilon raportin e kontrollit dhe të njëjtin raport e dorëzon tek komisioni për licencim si dhe tek subjekti i licencuar. Nëse konstatohen shkelje, komisioni për licencim është i obliguar që të ndërmerren veprime konform legjislacionit në fuqi.

Gabimet teknike janë pasaktësitë në të dhënat e regjistruara në regjistra kadastral. Ato gjinden me krahasimin e të dhënave origjinale, akteve juridike, planeve dhe gjendjes së regjistruar. Korrigjimet e tilla kanë të bëjnë më: sipërfaqen, kulturën, klasën, llojin e shfrytëzimit, formën, pozitën, numrin e njësisë kadastrale dhe të dhënat tjera për njësinë kadastrale. Ato mund të korrigjohen:

- Sipas detyrës zyrtare nëse zyrtari gjatë përpunimit të lëndës e konstaton gabimin, obligohet ta korrigjoj atë në regjistra dhe
- Me kërkesën e palës ku i njëjti e paraqet kërkesën për korrigjim në ZK, dhe ofron dëshmitë për korrigjim.

Për korrigjimet duhet të bëhet një aktvendim në bazë të të cilit bëhet ndryshimi. Këto korrigjime bëhen për të dhënat për njësi kadastrale.

22 Matjet kadastrale për të gjitha njësitë kadastrale

Matjet kadastrale bëhen me qëllim të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave nga terreni për regjistrim/korrigjim të njësive kadastrale në kadastër. Të gjitha matjet për regjistrim apo azhurnim të të dhënave kadastrale duhet të bëhen në sistemin referent gjeodezik shtetëror Kosovaref01.

22.1 Rrjeti referent gjeodezik shtetëror KOSOVAREF01

Rrjeti gjeodezik Kosovaref01 është homogjen dhe shtrihet në tërë territorin e Kosovës. Ky rrjet është i mbështetur në pikat permanente të njohura të rrjetit EUREF (Itali, Kroaci, Austri dhe Greqi).

Parametrat e datumit gjeodezik Kosovaref01 janë:

- Orientimi: ETRS89
- Elipsoidi: GRS80
- Gjysmëboshti i madh: 6378137
- Gjysmëboshti i vogël: 6356752.314
- Meridiani fillestar: Greenëich (0° 0' 0")
- Njësia në MF: Shkallë (°) 0.01745329251994328 dhe
- Origjina e gjerësisë: Ekuatori

Parametrat e projeksionit hartografik Kosovaref01 janë:

- Modeli i projeksionit: Transvers Merkator
- Meridiani qendror: 21°
- Përfshirja e zonës: 3°
- Zona e projektimit: 7
- Zhvendosja në lindje: 7500000
- Zhvendosja në veri: 0
- Shkalla e zvogëlimit në meridianin qendror: 0.9999
- Njësia e gjatësisë: Metër (m) dhe
- Origjina e gjerësisë: Ekuatori

Sistemi i pozicionimit KOPOS në Republikën e Kosovës është rrjet shtetëror unik me saktësi të pozitës në kohë reale.

KOPOS përbëhet nga gjithsejtë 8 stacione permanente të cilat mbulojnë territorin e Republikës së Kosovës.

Qyteti	Kodi	Latituda	Longituda	Lartësia Elipsoidale
Dragash	DRAG	42° 03' 43.85977"	20° 39' 16.32320"	1094.351
Kamenicë	KAME	42° 34' 52.73833"	21° 34' 42.92311"	662.296
Mitrovicë	MITR	42° 53' 19.55551"	20° 51' 57.04548"	566.531
Pejë	PEJA	42° 39' 41.30482"	20° 17' 18.50231"	581.464
Prishtinë	KCAP	42° 38' 46.64737"	21° 10' 06.01842"	581.464
Drenas	DREN	42° 40' 12.72243"	21° 11' 30.61312"	709.004
Rahovec	RAHO	42° 23' 50.58087"	20° 39' 26.29440"	475.610
Shtime	SHTI	42° 26' 3.003179"	21° 02' 18.65896"	623.998

Table 3 . Stacionet permanente të KOPOS-it

Metodat e matjeve që ofron KOPOS janë:

- Metoda Statike,
- Metoda Diferenciale dhe
- Metoda Kinematike - Real Time Kinematik-RTK.

Metoda Statike me GNSS janë metodat që mundësojnë arritjen e saktësisë maksimale në përcaktimin e pozicionit të pikave të palëvizshme me ndihmën e matjeve fazore GNSS dhe të dhënave bazë. Metoda Statike, që realizohen me matje fazore të një ose dy frekuencave dhe me përpunim pas procesit të matjeve.

Metoda Diferenciale përdoret kur kërkohet saktësi më e ulët se deri 0.5 m.

Metoda Kinematike – RTK (Real Time Kinematik) është metodë kinematike GNSS ku matjet përpunohen në kohë reale dhe ofron saktësi të lartë në plan dhe lartësi për nevojat e rilevimeve topografike.

Lloji i shërbimit	Përshkrimi	Rangu i saktësisë	
DGNSS	Saktësi e ulët në kohë reale (RTK -Code)	0.3	- 0.5 m
RTK	Saktësi e lartë në kohë reale (RTK -Phase)	0.02	- 0.04 m
RINEX	Saktësi e lartë (Post përpunim - Phase)	<0.01 m	

Table 4 . Shërbimet e sistemit KOPOS

22.2 Kategoritë e burimit të koordinatave

Burimi i koordinatave të pikave të njësive kadastrale është specifikuar në katër kategoritë në vijim:

1. **Pikë e fituar me matje (PM)** – koordinatat e pikave të njësive kadastrale të matura në terren me GPS apo Stacion Total duke u bazuar në rrjetin koordinativ Kosovaref01, e cila do të jetë pikë përfundimtare

2. **Pikë e transformuar (PT)** – koordinatat e pikave të njësive kadastrale të transformuara nga sistemi koordinativ Gauss Kryger në Kosovaref01, të cilat burimin e kanë nga manualet e ndarjeve,

3. **Pikë nga matjet takeometrike (PMT)** – koordinatat e pikave të njësive kadastrale të cilat janë fituar nga llogaritja e të dhënave nga fletoret takeometrike dhe matjet tjera plotësuese,

4. **Pikë e llogaritur nga matjet indirekte (PI)** –koordinatat e pikave të njësive kadastrale të cilat janë fituar nga llogaritja e matjeve me metoda indirekte dhe

5. **Pikë e digjitalizuar nga hartat kadastrale** (1:2500, 1:1000, 1:500) (PD)- koordinatat e pikave të njësive kadastrale të cilat janë krijuar nga vektorizimi i hartave kadastrale të skanuara dhe gjeoreferncuara.

22.3 Kodet e pikave

Pika e matur duhet të ketë kodin në bazë të listës së kodeve. Në vazhdim paraqiten kodet e pikave dhe përshkrimi i tyre.

Kodi	Përshkrimi
Pikat e Kufijve të parcelave	
1	Monument (guri natyral, i gravuar etj.)
2	Kunj - shtyllë metalike
3	Muri
4	Kunj - shtyllë plastike
5	Pikë detaji i ndërtesës (objektit)
6	Kunj-shtyllë e drurit
7	Kunj -shtyllë betoni
8	Pikë e matur/ e pa shënuar (për pikat të cilat mund të maten por nuk vendoset asnjë element për shënim)
Pikat e kontrollit	
10	Pikë e rendit të I-rë
11	Pikë e rendit të II-të
12	Pikë e rendit të III-të
13	Pikë e vjetër trigonometrike, poligonale, lidhëse
14	Pikë plotësuese e stabilizuar
Pikat tjera të detajit	
20	Pikat e ndërtesës, muret
21	Pusetë ujësjellësi
22	Pusetë e ujërave të zeza
23	Pusetë e ujërave atmosferike
24	Pusetë tjetër
25	Shtyllë elektrike
26	Shtyllë e ndriçimit
27	Skaji i malit
28	Anë rruge
29	Shenja të tjera
30	Aksi i rrugës
31	Gur kilometrik në rrugë
32	Dru i rëndësishëm
33	Kullë drejtimi, shtyllë ajrore
34	Largpërçues
35	Trafostacion
36	Ndërtesa publike dhe për banim kolektiv

Table 5. Kodet e pikave dhe përshkrimi

22.4 Standardet e matjeve kadastrale

Më poshtë janë të specifikuara dhe shpjeguara mënyrat dhe standardet e matjeve të njësive kadastrale.

22.4.1 Metodat gjeodezike të matjeve kadastrale

Në procedurën e matjeve kadastrale mund të shfrytëzohen: matjet polare, metoda e Sistemit Satelitor të Navigacionit Global (GNSS), si dhe kombinimet e tyre. Nëse nuk mund të realizohen matjet me njërën nga metodat e cekura më lartë, mund të përdoret edhe metoda ortogonale.

Matjet kadastrale duhet të bëhen sipas procedurave dhe standardeve në vijim:

1. Para fillimit të çdo matjeje me GNSS, ose pas përfundimit të çdo matjeje duhet të bëhet matja e një pike kontrolluese në distancën më të afërt nga lokacioni i realizimit të matjeve. Matja/vrojtimi me pajisje GNSS e pikës kontrolluese duhet të bëhet në intervalin kohor jo më pak se 1 minutë;

2. Matjet/vrojtimet me GNSS për pikat e kufijve të njësive kadastrale duhet të bëhen në intervalin kohor jo më pak se 10 sekonda;

3. Matja me stacion total bëhet duke shfrytëzuar tri pika fikse. Një pikë stacionimi dhe dy pika orientuese. Pika fikse nga e cilat maten pikat kufitare të njësive kadastrale dhe matja në pikat orientuese duhet të jenë nga baza gjeodezike (Kosovaref01) ose të vendosura si pika plotësuese të matura me GNSS. Në fund të rilevimit nga stacioni i njëjtë, bëhet matja në njërën nga pikat orientuese;

4. Në matjen me stacion total mund të përdoret edhe metoda e stacionimit të lirë. Në këto raste duhet t'i kemi minimum tri pika orientuese. Pas përfundimit të rilevimit duhet të bëhet matja/kontrolli në njërën nga pikat orientuese dhe

5. Fajlli origjinal i matjeve të terrenit për pikat e kontrollit dhe për pikat e kufijve të njësive kadastrale duhet të arkivohet dhe ruhet/emërtohet me numrin e protokollit të lëndës.

22.4.2 Saktësia gjatë matjeve me GNSS

Të gjitha kategoritë e burimit të koordinatave të specifikuara për të fituar statusin e Pikë e Verifikuar (PV), duhet të plotësojnë kriteret e saktësisë të cilat janë të paraqitura në tabelën më poshtë, pas matjeve në terren.

Saktësia relative gjatë matjeve me GNSS për pikat detaje si dhe devijimi standard për pikat e dyfishta të matura janë të paraqitura në tabelën si në vijim:

